



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/251
Datë: 12.03.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 mars 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Bujqësi Organike.
2. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet e tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural/Ministarstvo Poljoprivrede,
Šumarstva i Ruralnog Razvoja/Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**

KONCEPT DOKUMENTI PËR BUJQËSI ORGANIKE

Prishtinë 2024

Hyrje	4
Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit	8
Toka bujqësore	10
Madhësia e fermës.....	11
Përshkrimi i politikës dhe kornizës ligjore ekzistuese	14
Problemi kryesor, shkaqet dhe palët e interesuara	17
Kapitulli 2: Objektivat.....	37
Kapitulli 3: Opsionet.....	41
3.1: Opsioni i parë asnjë ndryshim	41
3.2. Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit te ligjit	41
3.3. Opsioni i tretë	42
Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme	52
NDIKIMET MJEDISORE	58
TË DREJTAT THEMELORE	59
Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave	59
Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve	62
Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme	63
Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me tri opsionet.....	81
Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm	85
Shtojca 1: Formulari i vlerësimit të ndikimit ekonomik	87
Shtojca 3: Formulari i vlerësimit të ndikimit në mjedis.....	93
Shtojca 4: Formulari i vlerësimit të ndikimit për të drejtat themelore	96

LISTA E SHKURTESAVE

LBO	Ligji për Bujqësi Organike
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
DPBT	Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve
AUV	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
IBK	Instituti Bujqësor i Kosovës
DPZHR	Departamenti i Politikave të Zhvillimit Rural
DSHKT	Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike
DAESB	Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave të Bujqësisë
PBZHR	Plani për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
AZHB	Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë
ISMAFRD	Mbështetja Institucionale e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
APK	Agjencia Pyjore e Kosovës
DP	Departamenti i Pyjeve
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
AKMM	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
PKVM	Plani i Veprimit në Mjedis të Kosovës
UAA	Zonë Bujqësore e Shfrytëzuar
PVBO	Plani i Veprimit për Bujqësi Organike
PPJD	Produkte pyjore jo-drusore
BMA	Bimë Mjekësore dhe Aromatike
SHBOK	Shoqata e Bujqësisë Organike e Kosovës
SHO	Shoqata Organika
KBO	Komisioni për Bujqësinë Organike
TK	Trupat e Kontrollit
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
OJQ/GO	Organizata Joqeveritare /Organizata Qeveritare
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNFAO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë
BE	Bashkimi Evropian
FIBL	Instituti Kërkimor i Bujqësisë Organike
IFOAM	Federata Ndërkombëtare e Lëvizjes së Bujqësisë Organike
GIZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asocimit

Hyrje

Projekt Koncept Dokumenti për Bujqësi Organike është përgatitur nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në përputhje me Udhëzuesin dhe Doracakun për Hartimin e Koncept Dokumenteve Nr. 95/2018 të datës 21/03/2018 dhe në përputhje me rregullat dhe procedurat e Qeverisë.

Spektori i Bujqësisë Organike është me rëndësi veçantë për fermerët prodhues të kulturave bujqësore i cili ka ndikim direkt në mirëqenien sociale të tyre, si dhe ndikim në zhvillimin e një bujqësie të qëndrueshme me ndikim ekonomik të çdo vendi, çdo herë duke pasur parasysh plotësimin e nevojave të popullatës për ushqim cilësor.

Në Republikën e Kosovës, problemet në sektorin e Bujqësisë Organike janë të shumta, duke filluar në strukturën organizative institucionale në të cilën nuk janë të definuara përgjegjësitë e këtij sektori të ndjeshëm dhe të veçantë.

Në aspektin legjislativ, sektori i Bujqësisë Organike në Kosovë është zhvilluar në periudhën e vitit 2012, kur është aprovuar Ligji Nr. 04/L-085, i cili ndërkohë ka pasur vetëm një ndryshim dhe plotësim të dispozitave ndëshkimore (LIGJI NR.08/L-081), por jo edhe në aspektet tjera përmbajtësore. Ligji është plotësuar me udhëzime administratave (UA) kohë pas kohe, por të cilat nuk i përmbushin nevojat dinamike aktuale të sektorit të Bujqësisë Organike.

Bazuar në gjendjen aktuale të sektorit të Bujqësisë Organike, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) ka hartuar këtë koncept dokument (KD), në të cilin janë identifikuar dhe analizuar mangësitë e legjislacionit aktual, të cilat kanë ndikim në zhvillimin e përgjithshëm të sektorit të bujqësisë, dhe i cili do t'i paraprijë Ligjit të ri për Bujqësi Organike në Republikën e Kosovës.

Synimi i përgjithshëm i këtij koncept dokumenti është që të krijohet korniza ligjore e cila mundëson: (i) Importin e inputeve cilësore, të cilat janë të domosdoshme për mbrojtjen e fermerëve prodhues; (ii); Ndikim në zhvillimin e sektorit të prodhimtarisë bimë cilësore;

(iii) Rritjen e rendimenteve mesatare organike në nivel vendi; (iv) Përfitimi i produkteve kualitative të cilat do të kenë ndikim në shëndetin publik. Objektivat specifike të përcaktuara me këtë koncept

dokument janë: (i) Transpozimi i legjislacionit të BE-së (‘Acquis’) nga sektori i Bujqësisë Organike në legjislacionin vendor; (ii) Përmirësimi i kontrollit sipas standardeve ndërkombëtare (Rregullores së re të BE-së 2018/848); (iii) Përcaktimi i institucionit përgjegjës për certifikim të produkteve organike, realizimin e testimeve duke zbatuar standardet ndërkombëtare; (iv) Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e Ligjit dhe inspektimin e inputeve pas regjistrimit të tyre në Listën Nacionale të Inputeve Organike, dhe Listën FIBL (Lista e Inputeve Organike/Instituti Zviceran i Hulumtimeve për Kontroll Biologjike); (v) mbrojtja e fermerëve vendor nga importimi dhe tregtimi i produkteve jo cilësore dhe ngritja e vetëdijes për rolin dhe rëndësinë e Bujqësisë Organike.

Pas të gjitha analizave rreth ndikimeve në sektorin e Bujqësisë Organike, janë përfituar tri (3) opsione të ndryshme të cilat janë shqyrtuar për arritjen e këtyre objektivave, dhe në fund është konkluduar se opsioni më i përshtatshëm është “Opsioni 3”, që nënkupton hartimin e Ligjit të ri për Bujqësi Organike në Republikën e Kosovë.

Në tabelat në vijim, janë paraqitur në formë të përmbledhur të dhënat bazë të Projekt Koncept Dokumentit për Bujqësi Organike.

Tabela me informacione të përgjithshme për koncept dokumentin

Titulli	Koncept Dokumenti për Bujqësi Organike
Ministria bartëse	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural Departamenti për Politika Bujqësore dhe Tregje Divizioni i Prodhimtarisë Bimore dhe Ujitjes
Personi kontaktues	Bali Lestrani 038/38 418 044/140711
Plani Kombëtar për Zhvillim	Qëllimi zhvillimor dhe qëllimi strategjik: • 1.9 Ndërtimi i lidhjeve të qëndrueshme në mes të fermerëve, përpunuesve dhe shitësve me pakicë • Masa Strategjike: Përmirësimi i pozitës së fermerëve në zinxhirin e vlerës • Aktivitetet– Hartimi i Koncept Dokumentit për Bujqësi Organike
Prioriteti strategjik	Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025 2.10. Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural 2.10.5 Siguria e ushqimit Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030 Shtylla e I – Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik: Qëllimi Zhvillimor: Ekonomi digjitale, qarkore dhe konkurruese: Qëllimi Strategjik: 1.9 Ndërtimi i lidhjeve të qëndrueshme mes fermerëve, përpunuesve e shitësve me pakicë. Objekti strategjik: Avancimi i politikave për siguri ushqimore dhe përafrimi i tyre me standardet e BE-së, të cilat synojnë të sigurojnë një nivel të lartë të ushqimit për njeriun dhe shëndetin e bimëve duke aplikuar bujqësinë organike. Objektivat specifike: - Harmonizimi/përafrimi me Rregulloren e BE-së për Bujqësinë Organike Nr. 2018/848. - Përf forcimi i sistemit të kontrollit nga autoritetet përgjegjëse për zbatimin e rregullave për certifikim të produkteve organike, dhe realizimin e testeve laboratorike për mbetjet e Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve tek produktet organike.

	- Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e Ligjit dhe inspektimi i produkteve organike pas regjistrimit të tyre në Listën Kombëtare të Produkteve Organike. - Mbrojtja e fermerëve vendor nga importimi dhe tregtimi i produkteve jo cilësore dhe ngritja e vetëdijes për rolin dhe rëndësinë e produkteve organike.
Grupi punues	Me Vendimin Nr.120 Ref. ZSP 88/24 i datës 05.02.2024, Sekretarja e Përgjithshme e MBPZHR-së emëron Ekipin Punues për hartimin e Koncept Dokumentit për Bujqësi Organike, në përbërje: Bali Lestrani - Kryesues, Albert Behrami - anëtar, Valdete Avdiu - anëtare, Arton Bekolli - anëtar, Sanije Qelaj - anëtare, Kasum Morina - anëtar, Shyhrete Bunjaku - anëtare, Faton Nagavci - anëtar, Fatmire Tahiri-Mirena - anëtare, Veton Çoçaj - anëtar, Leonora Arifi - anëtare, Merita Ramaxhiku - anëtare, Ekrem Ahmeti - anëtar, Valbona Fetahu - anëtare, Besnik Sadriu - anëtar.
Informata shtesë	Republika e Kosovës në proceset integruuese në BE është zotuar dhe ka marrë të gjitha obligimet në përafrimin dhe harmonizimin e legjislacionit dhe politikat zhvillimore, që kanë të bëjnë me shëndetin e njeriut, kafshëve dhe bimëve në zinxhirin argo-ushqimorë që janë fundamentale për shëndetin e konsumatorit, zhvillimin ekonomik të vendit dhe mbrojtjen e mjedisit. Raporti për Kosovën i Komisionit Evropian i vitit 2022 dhe 2023 citon: “Të sigurojë me kohë mjetet dhe burimet e nevojshme për funksionimin efektiv të Sistemit të Menaxhimit të Kontrollit të Ushqimit dhe Gjurmues mërisë dhe Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Laboratorik të zhvilluar me mbështetjen e BE-së pasi ato janë të rëndësishme në sigurimin e pajtueshmërisë së produkteve ushqimore të prodhuara ose të tregtuara nga Kosova me sigurinë ushqimore, shëndetin e kafshëve, mirëqenien e kafshëve dhe standardet e shëndetit të bimëve, që janë parakusht për një sektor konkurrues argo-ushqimor; → të zgjedhë operatorin për menaxhimin e impiantit depozitues dhe sistemin e grumbullimit të nënprodukteve bimore dhe të fillojë me funksionimin e impiantit depozitues”

Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit

Koncept Dokumenti ka për qëllim të adresojë çështjet, të cilat nuk kanë qenë të përfshira me rregullativen aktuale ligjore të bujqësisë organike. Gjatë viteve të fundit është arritur një përparim i kënaqshëm sa i përket zhvillimit të bujqësisë organike, megjithatë mungesa e biopesticideve dhe mos ruajtja e pjellorisë së tokës duhet adresuar në të ardhmen.

Zhvillimi i sektorit të bujqësisë, me theks të veçante bujqësia organike ka rol të rëndësishëm për arritjen e synimeve strategjike të përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës duke përfshirë edhe sigurimin e ushqimit dhe mbrojtjen e mjedisit.

Në bujqësinë organike është me rëndësi: mbrojtja e mjedisit dhe klimës, ruajtjen e pjellorisë afatgjatë të tokës, biodiversitetit, standardet e larta të mirëqenies së kafshëve, inkurajimi i ruajtjes së racave të rralla dhe kultivarëve vendor që janë në rrezik zhdukjeje, furnizimi me material gjenetik bimor të përshtatur me nevojat dhe objektivat specifike të bujqësisë organike.

Kjo do të mundësojë rritjen e prodhimit vendor të produkteve bujqësore organike dhe përmirësimin e kushteve ekonomike dhe sociale të fermerëve.

Koncept Dokumenti ka për qëllim të adresojë çështjet, të cilat kanë munguar sa i përket specifikave në prodhimtarin bujqësore organike dhe akuakulturë dhe specifikat për përpunimin e produkteve organike për njerëz dhe kafshë.

Legjislacioni

Korniza aktuale ligjore e Kosovës për Bujqësi organike është rregulluar me Ligjin Nr. 04/L-085, që është rishikuar me qëllim të harmonizimit me legjislacionin e BE-së, përkatësisht Rregulloreve të BE-së 834/2007 dhe 889/2008. Në bazë të këtyre Rregulloreve të BE-së për bujqësi organike është hartuar Ligji për bujqësi organike Nr. 04/L-085 në vitin 2012. Mënyra më e mirë për të përcaktuar mangësitë që dalin nga korniza aktuale ligjore e Kosovës është ta krahasojmë atë me kornizën e re ligjore të BE-së për bujqësi organike.

Ligjit Nr. 04/L-085 për bujqësi organike dhe aktet nënligjore nuk janë të përafëruar me Rregulloren (EU) Nr. 2018/848, prandaj korniza aktuale ligjore e Kosovës për bujqësi organike është e pa kompletuar siç përcaktohet në rregulloret e BE-së.

Megjithatë, legjislacioni ekzistues nuk është zbatuar plotësisht, për shkak të mungesës së akteve nënligjore për ngritjen e sistemit të kontrollit.

Me qëllim të zbatimit me efektivitet të këtij Ligji, në vitin 2019 Ministria ka nxjerrë tetë (8) Udhëzime Administrative, si në vijim:

1. Udhëzim Administrativ (MBPZHR) Nr. 01/2019, Për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Përbërjen e Komisionit për Bujqësi Organike të datës 17.01.2019.
2. Udhëzim Administrativ (MBPZHR) Nr.02/2019, Për Sistemin e Kontrollit, Autorizimin e Kontrollit, Trupat e Kontrollit dhe Rregullat për Zbatimin e tyre në Prodhimtarinë Organike të datës 17.01.2019.
3. Udhëzim Administrativ (MBPZHR) Nr.03/2019, Për Përcaktimin e Rregullave për Prodhimin Bimor Organik të datës 17.01.2019.
4. Udhëzim Administrativ (MBPZHR) Nr.04/2019, Për Prodhimin Blegtoral dhe Ushqimin Organik për Kafshë të datës 17.01.2019.
5. Udhëzim Administrativ (MBPZHR) Nr.05/2019, Për Prodhimin e Akuakulturës Organike të datës 17.01.2019.
6. Udhëzim Administrativ (MBPZHR) Nr.06/2019, Për Kriteret, Standardet dhe Kushtet e Importimit të Produkteve Organike në Kosovë të datës 17.01.2019.
7. Udhëzim Administrativ (MBPZHR) Nr.07/2019, Për Përcaktimin e Logos së Prodhimit Organik dhe kërkesat Specifike për Etiketim të datës 17.01.2019.
8. Udhëzim Administrativ (MBPZHR) Nr.08/2019, Për Rregullat dhe Metodat e Prodhimit të Produkteve Organike të Përpunuara të datës 17.01.2019.

Fushëveprimi i legjislacionit përfshin produktet bujqësore të papërpunuara, produktet bujqësore të përpunuara për përdorim si ushqim, ushqimin për kafshë, materialin shumëvegjetativ dhe farat për kultivim dhe majat e përdorura si ushqim dhe ushqim për kafshë. Ligji përmban rregullat e prodhimit të bimëve, blegtorisë dhe akuakulturës, rregullat e përpunimit, etiketimit, kontrollit dhe importit.

Që nga hyrja në fuqi e Ligjit Ligjin Nr. 04/L-085 për Bujqësi organike nuk ka pasur plotësime dhe ndryshime. Por, Komisioni Evropian ka rishikuar legjislacionin për bujqësi organike dhe ka publikuar rregulloren e re për bujqësi organike (BE) 2018/848 në maj të viti 2018. Kjo rregullore përcakton parimet e prodhimit organik dhe përcakton rregullat në lidhje me prodhimin organik, certifikimin përkatës dhe përdorimin e indikacioneve që i referohen prodhimit organik në etiketim dhe reklamim, si dhe rregullat për kontrollet shtesë ndaj atyre të përcaktuara në Rregulloren (BE) 2017/625.

Rëndësia e përafrimit gradual të legjislacionit me Acqui-në e BE-së është përcaktuar me Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit (MSA) ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi më datën 1 Prill 2016. MSA-ja përfaqëson marrëdhënien e parë kontraktuale

gjithëpërfshirëse ndërmjet Kosovës dhe BE-së dhe është një moment historik i rëndësishëm në procesin e integritimit evropian të Kosovës

Krahas obligimeve nga MSA-ja, Kosova duhet të përmbushë edhe kërkesat që dalin nga Raportet Vjetore të KE-së për Kosovën. Dy raportet e fundit, për vitin 2020 dhe 2021, kanë theksuar vazhdimisht fushën e bujqësisë organike, si një nga fushat e rëndësishme për përmirësime. Prandaj, miratimi i kornizës së re ligjore për bujqësi organike konsiderohet si prioritet për Kosovën.

Toka bujqësore

Bazuar nga Anketa e Ekonomive Bujqësore, sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore ka pasur një trend të përafërt të shfrytëzimit në periudhën kohore 2017-2022. Gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore në vitin 2022 ishte 420,482 ha, që ishte sipërfaqe e përafërt me atë të vitit 2021. Sipërfaqja mesatare e tokës së shfrytëzuar bujqësore për Ekonomi Bujqësore ishte 3.2 ha. Ekonomitë familjare kanë rreth 2 - 5 ha të sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore e që përbejnë rreth 23.3% të sipërfaqes së përgjithshme. Numri i Ekonomive Bujqësore në Kosovë është 130.775. Sipas të dhënave të pranuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), toka bujqësore e privatizuar deri me tani është përafërsisht 30,217 ha. Ndërsa ka mbetur nën menaxhim të AKP-së përafërsisht rreth 40,000 ha tokë bujqësore. **LIGJI NR.08/L-125 Për Pronën Publike 23. Nëntor 2023**

Shfrytëzimi i tokës bujqësore sipas kategorive

	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Tokë e punueshme – ara	186,954	188,359	188,365	188,372	188,375	188,404
Perime, Kopshte dhe Fidanishte	9,858	9,398	10,070	10,252	10,283	10,079
Plantacione të pemëve	6,247	7,687	9,244	10,029	10,144	10,377
Plantacione të vreshtave	3,199	3,272	3,367	3,437	3,471	3,472
Livadhe dhe kullosa						
përfshire tokën e përbashkët	218,314	218,152	217,932	217,102	217,107	216,998

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('17,'18,'19,'20, '21 '22)

Përveç livadheve dhe kullosave me 216,998 ha, që përbën 51.6% të gjithsej sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore, pastaj janë tokat e punueshme, me pjesëmarrje prej 44.8%, që paraqet sipërfaqen prej 188,404 ha, ku përfshihet edhe sipërfaqja e perimeve në fushë të hapur (si

kulturë e parë) (8,584 ha) dhe perimet në serra po ashtu si kulturë e parë (583.3 ha), pra gjithsej 9,167 ha me perime (ASK, 2023). Drithërat kokërr janë mbjellë në 124 617,49 ha ose (66,1%) të sipërfaqes së tokës së punueshme, grupi i dytë për nga madhësia e sipërfaqes së kulturave në tokën e punueshme - ara janë kulturat foragjere me 37. 614,61 ha ose (20,0 %) të sipërfaqes së tokës së punueshme (ASK, 2023).

Sipërfaqet e mbjella të certifikuar sipas standardeve organike janë 1,990 ha, dhe rreth 373 448 ha janë zona të certifikuar për grumbullimin e Produkteve Pyjore Jo-Drusore (PPJD; FIBL & IFOAM – Organics Internacional, 2023).

Madhësia e fermës

Sipërfaqja e tokës së punueshme e shfrytëzuar i referohet sipërfaqes kryesore gjatë një viti të prodhimit bujqësor. Në vitin 2023, gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore ishte 420,482 ha, nga kjo sipërfaqe gjithsej toka e punueshme-ara ishin 186,404 ha apo 44.8% ku janë të përfshira 103,723 ekonomi bujqësore.

Madhësia e ekonomive sipas sipërfaqes së tokës së punueshme, 2020

Madhësia e fermës	Sipërfaqja (ha)	Pjesëmarrja (%)	Nr. i Ekonomive Bujqësore	Pjesëmarrja (%)
0 dhe më pak se 0.5	6,453	3.5	31,290	30.2
0.5 deri më pak se 1	11,999	6.4	17,560	16.9
1 deri më pak se 2	29,005	15.6	22,560	21.8
2 deri më pak se 5	38,665	20.7	23,383	22.5
5 deri më pak se 10	64,819	34.8	7,063	6.8
10 deri më pak se 20	16,800	9.0	1,429	1.4
20 deri më pak se 30	5,255	2.8	240	0.2
30 e më shumë	13,393	7.2	198	0.2
Gjithsej*	186,389	100%	103,723	100%

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore 2020

*Nuk janë përfshirë EB të komunave veriore

Në Kosovë madhësia e fermës prej 5 deri më pak se 10 ha përfaqëson 35% të gjithsej sipërfaqes së tokave të punueshme arave, pasuar nga madhësia e fermave prej 2 deri më pak se 5 ha (21%), madhësia 1 deri më pak se 2 ha (16%) dhe madhësitë e tjera me më pak pjesëmarrje ku madhësia me sipërfaqen më të vogël është ajo prej 0 deri më pak se 0.5 ha.

Inputet organike në bujqësi

Të gjitha inputet organike importohen nga shtete e BE-së nga kompanitë vendore, të cilat nuk janë subjekt i regjistrimit. Mirëpo në Kosovë inputet organike të importuara para se të regjistrohen në listën e PMB-ve duhet të janë të regjistruara në një shtet anëtar të BE-së sipas listës së shteteve përkatëse të aprovuara nga organet kompetente.

Kontrolli i cilësisë së inputeve organike

Aktualisht asnjë institucion nuk e kryen testimin e cilësisë (materie aktive dhe materie ndihmëse) dhe të efikasitetit të inputeve organike në vendin tonë. Të gjitha testimet bazohen në bazë të testeve që kryejnë kompanitë prodhuese në BE. Testimi fushor për efikasitet duhet të realizohet nga Institutet e specializuara si Instituti Bujqësor i Kosovës dhe Universitetet që kanë programe specifike për bujqësinë organike.

Ofrimi i Shërbimeve Këshillimore për bujqësi organike

Në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) është Departamenti për Shërbime Këshillimore dhe Teknike i cili në bashkëpunim me këshilltaret në nivel komunal kanë mandatin për të ofruar këshilla për nën sektorët e ndryshëm të bujqësisë duke përfshirë edhe bujqësinë organike. Departamenti ka rol organizativ, përmes së cilit duhet të shpërndahen të gjitha informacionet lidhur me prodhimtarin organike bimorë dhe shtazorë dhe përpunimi i produkteve specifike dhe të organizoj trajnime.

Shoqata ORGANIKA e themeluar në vitin 2013 nga operatorët kryesor të sektorit ka ofruar që nga viti 2017 trajnime dhe këshilla për akterët e sektorit për rëndësinë e bujqësisë organike, kërkesat e standardit organik - kërkesat e rregullores së BE-së, si dhe ka ofruar këshilla për kompanitë që janë në procesin e certifikimit organik – pra, ka ofruar trajnime dhe këshilla specifike për bujqësinë organike. ORGANIKA, si pjesë e bashkëpunimit me MBPZHR, ka ofruar trajnime dhe takime informuese për stafin e MBPZHR duke përfshirë këshilltaret e Departamentit për këshillëdhënës, Inspektorët fitosanitar të AUV dhe stafit të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB).

Zhvillimi i bujqësisë organike

Institucionet kryesore që janë të përfshira për zhvillimin e bujqësisë organike janë: MBPZHR, MMPHI, DPBT, IBK, AUV, Dogana, Kompanitë Prodhuese, Institucionet akademike, Shoqatat,

OJQ-të prandaj duhet forcuar bashkëpunimin në mënyrë që të prodhojmë produkte bujqësore organike sa më të sigurta për nevojat vendore dhe eksport. Sektori organik është ende në fazën e hershme të zhvillimit dhe është i orientuar kryesisht te Bimët Mjekësore dhe Aromatike (BMA) dhe Produktet Pyjore Jo-Drunore (PPJD). Megjithatë, sektori përfshin edhe kërpudhat, kungullin për prodhimin e farave/prodhimin e vajit organik, mjaltit dhe arrat. Tregu vendor i produkteve organike është ende i pazhvilluar, pasi që kërkesa për produkte organike mbetet e kufizuar. Produktet organike kryesisht eksportohen si produkte gjysmë të përpunuara, ku deri në 95% e të gjithë prodhimit eksportohet në vendet e BE-së - Gjermani, Austri, Zvicër, Holanda etj. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, si organ kompetent, është përgjegjëse për ngritjen e një sistemi të kontrollit për prodhimin organik, duke përfshirë organet e kontrollit që kryejnë procedurat e kontrollit dhe certifikimit për operatorët organikë. Ligji që rregullon prodhimin organik parashikon që këto kontrolle të përfshijnë inspektimet fizike të objekteve të prodhimit dhe të përpunimit, verifikimin e mbajtjes së të dhënave dhe marrjen e mostrave të prodhimit, tokës dhe bimëve për të analizuar mbetjet e mundshme të pesticideve (PMB-ve), prodhimet e paautorizuara dhe/ose papastërtitë, si dhe verifikimin e praktikave të prodhimit që nuk janë në përputhje me prodhimin organik.

Tabela 2: Të dhënat sa i përket produkteve organike (ha)

Viti	Sipërfaqet e certifikuara organike të kultivuara (ha)	Grumbullimi i PPJD-ve (ha)
2018	788	373.488
2019	1.036	373.488
2020	1.604	373.488
2021	1.718	373.488
2022	667	373.488

Burimi: DPBT, DAESB, dhe Shoqata Organika

Në tabele pasqyrohen të dhënat sa i përket sipërfaqeve të certifikuara me produkte organike për pesë vitet e fundit 2018-2022, megjithatë të dhënat e disponueshme për prodhimin organik janë të kufizuara.

Përshkrimi i politikës dhe kornizës ligjore ekzistuese

Tabela 1: Dokumentet legjislativ dhe politike dhe përgjegjësitë e institucioneve

Dokument i politikave, ligj ose akti nën-ligjor	Lidhja (Linku) me politikën apo dokumentin planifikues përmes internetit ose me aktet ligjore në Gazetën Zyrtare	Institucioni (et) shtetëror (e) përgjegjës (e) për zbatim	Roli dhe detyrat e Institucionit (eve)
Ligji Nr. 02/L-122 për Bujqësinë Organike	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2576	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë/ Instituti Bujqësor i Kosovës në Pejë (IBK)	Hartimi i politikave dhe legjislacionit për bujqësi organike dhe zbatimin e legjislacionit primar dhe sekondar Marrja e mostrave dhe lëshimi i certifikatave fitosanitare dhe shëndetin e kafshëve nga AUV Analizimi i mostrave nga IBK
Ligji Nr. 04/L-085 për Bujqësi organike	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2604	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) Instituti Bujqësor i Kosovës në Pejë (IBK) Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë/ (AUV)	Hartimi i politikave dhe legjislacionit për bujqësi organike dhe zbatimin të Ligjit. Analizimi i mostrave të marra nga AUV për zbatimin e legjislacionit primar dhe sekondar.
Udhëzim Administrativ Nr. 01/2019 (MBPZHR), Për detyrat, përgjegjësitë dhe përbërjen e Komisionit për Bujqësi Organike	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=65759	MBPZHR AUV	Me këtë Udhëzim Administrativ Përcaktohen detyrat, përgjegjësitë dhe përbërjen e Komisionit për Bujqësi Organike.
Udhëzim Administrativ Nr. 02/2019 (MBPZHR),	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15171	MBPZHR AUV IBK	Me këtë Udhëzim Administrativ Përcaktohen sistemi i kontrollit, autoritetit të

Për sistemin e kontrollit, autoritetit e kontrollit, trupat e kontrollit dhe rregullat për zbatimin e tyre në prodhimtarin organike			kontrollit, trupat e kontrollit dhe rregullat për zbatimin e tyre në prodhimtarin organike.
Udhëzim Administrativ Nr. 03/2019 (MBPZHR), Për përcaktimin e rregullave për prodhimin bimor organik	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10122	MBPZHR AUV IBK	Me këtë Udhëzim Administrativ Përcaktohen rregullat për prodhimin bimor organik
Udhëzim Administrativ Nr. 4/2019 (MBPZHR), Për prodhimin blegtoral dhe ushqimin organik për kafshë	https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/133_U.A.Nr. 04.2019 Per Prodhimin Blegtoral dhe Ushqim Organik per Kafshe.pdf	MBPZHR AUV	Me këtë Udhëzim Administrativ Përcaktohet prodhimi blegtoral dhe ushqimi organik për kafshë
Udhëzim Administrativ Nr. 05/2019 (MBPZHR), Për prodhimin e akuakulturës organike	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7863	MBPZHR AUV IBK	Me këtë Udhëzim Administrativ Përcaktohet prodhimi akuakulturës organike
Udhëzim Administrativ Nr. 06/2019 (MBPZHR), Për kriteret, standardet dhe kushtet e importit të produkteve organike në Kosovë	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7760	MBPZHR AUV IBK	Me këtë Udhëzim Administrativ Përcaktohen kriteret, standardet dhe kushtet e importit të produkteve organike në Kosovë
Udhëzim Administrativ Nr. 07/2019 (MBPZHR), Për përcaktimin e logos së prodhimit organik dhe	https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/136_U.A.Nr. 07.2019 Per Percaktimin e Logos se Prodhimit Organik dhe Kerkesa	MBPZHR AUV IBK	Me këtë Udhëzim Administrativ Përcaktohet Logo e prodhimit organik dhe kërkesat specifike për etiketim

kërkesat specifike për etiketim	_Specifike per Etiketi m.pdf		
Udhëzim Administrativ Nr. 08/2019 (MBPZHR), Për rregullat dhe metodat e prodhimit të produkteve organike të përpunuara	https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/137_U.A.Nr_08.2019_Per_Rrgullat_dhe_Metodat_e_Prodhimit_te_Produketeve_Organike_te_Perpunuara.pdf	MBPZHR AUV IBK	Me këtë Udhëzim Administrativ Përcaktohen rregullat dhe metodat e prodhimit të produkteve organike të përpunuara
Udhëzim Administrativ (MBPZHR), Nr. 04/2008 Për kultivimin, grumbullimin, qarkullimin dhe shfrytëzimin e produkteve pyjore jo drusore	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7564	MBPZHR AUV IBK	Me këtë Udhëzim Administrativ Përcaktohet kultivimi, grumbullimi, qarkullimi dhe shfrytëzimi i produkteve pyjore jo drusore. Koha dhe mënyra e shfrytëzimit, kushtet dhe mënyra e blerjes dhe lëshimit të lejes për qarkullim, përmbajtja dhe mënyra e lëshimit të fletë dërgesës.
Ligji Nr.05/L-087 për Kundërvajtje (Gazeta Zyrtare nr.33/08/09/2016	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12839	Ministria e Drejtësisë MBPZHR	Zbatojnë dispozitat ligjore ne fuqi
Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare Nr.20/21.06.2016	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12559	Ministria e Administratës Publike MBPZHR	Zbatojnë dispozitat ligjore ne fuqi
Ligji Nr.08/L-137 për Pyjet	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=71815	MBPZHR Agjencia Pyjore e Kosovës - APK	Ky ligj rregullon planifikimin, mbrojtjen, silvikulturën, shfrytëzimin e produkteve drusore dhe jo drusore, pronësinë, shpronësimin, përgjegjësinë organizative dhe detyrat e institucioneve pyjore, financimin publik, hulumtimet në pylltari,

			mbikëqyrjen, inspektimin dhe sanksionet.
Ligji Nr.08/L-072 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=71733	MBPZHR AZHB	Ky ligj ka për qëllim të rregulloj hartimin dhe zbatimin e politikave kombëtare për bujqësi dhe zhvillim rural, gjithashtu rregullon partneritetin me partnerë social dhe ekonomik në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, dhe është pjesërisht në pajtueshmëri me aktet e BE-së.

Problemi kryesor, shkaqet dhe palët e interesuara

Pema e problemit, që paraqet problemin kryesor, shkaqet e tij dhe efektet

Efektet	<u>Rregullat nuk zbatohen siç duhet - Rregullat janë të pakompletuara</u> 1. Ndikim në sistemin e kontrollit në tregun e brendshëm organik. 2. Rënie e besueshmërisë së konsumatorëve lidhur me origjinën dhe përmbajtjen e produkteve organike dhe në mos caktimin e kriterëve lidhur me përbërjen e ushqimit organik të përpunuar. 3. Mos përfshirja e produkteve që lejohen të përdoren në prodhimtarin organik dhe vështirësi në certifikimin e fermerëve sipas standardeve të BE-së. 4. Besueshmëria gjatë procesit të konvertimit dhe certifikimit, dhe paqartësitë tek prodhuesit e sektorit të Bujqësisë Organike të cilët produktet e tyre i përfitojnë nga farërat dhe materiali riprodhues vegjetativ. 5. Vështirësi në mbikëqyrjen e organeve të kontrollit për verifikimin e përputhshmërisë, por edhe identifikimin e produkteve të prodhuara nga Organizmat e Modifikuar Gjenetikisht (OMGJ-të). 6. Vështirësi në importin dhe eksportin e produkteve organike. 7. Pamundësi e fermerëve të certifikohen në grup dhe pamundësi e certifikimit të Verërave Organike. 8. Barra administrative e lartë për operatorët 9. Masat ndaj personave fizik apo juridik të cilët veprojnë në kundërshtim me Ligjin për Bujqësi Organike.
Problemi kryesor	Avancimi i infrastrukturës ligjore për produktet për bujqësi organike krahas rregulloreve dhe direktivave të BE-së

Shkaqet	<u>Rregullat nuk zbatohen siç duhet:</u> 1. Zbatimi jo i plotë i standardeve të BE-së në sistemin e kontrollit për tregun e brendshëm organik dhe mungesa e kriterëve lidhur me ushqimin organik të përpunuar. 2. Përshkrimi i mangët i emërtimeve që përdoren në etiketimin, materialin reklamues, ushqimet organik të përpunuara si dhe dokumentet tregtare për produktet organike. 3. Mungesa e Listës zyrtare për Inpute Organike. 4. Mungesa e kontrolleve dhe inspektimeve rigoroze gjatë procesit të konvertimit dhe certifikimit, dhe mungesa e informacioneve për prodhimin e produkteve të ndryshme nga farërat dhe materiali riprodhues vegjetative Kontrolle dhe inspektime të pakta gjatë procesit të konvertimit dhe certifikimit, dhe mungesa e informacioneve për prodhimin e produkteve të ndryshme nga farërat dhe materiali riprodhues vegjetative. 5. Mungesa e rregullave shtesë për delegimin e detyrave të kontrollit zyrtar dhe detyrave që lidhen me veprimtari të tjera zyrtare, si dhe mungesa e kontrolleve për produktet e prodhuara përmes Organizmave të Modifikuar Gjenetikisht (OMGJ). 6. Mangësia e informacioneve për importin dhe eksportin e produkteve organike dhe atyre në konvertim. 7. Mungesa e rregullave për certifikimin grupor për standardin organik dhe përfshirjes së certifikimit të Verërave Organike. 8. Nivel i pamjaftueshëm i thjeshtimit dhe digjitalizimit. 9. Mos zbatimi i sanksioneve të shqiptuara nga gjykatat. Rregullat janë të pakompletuara Ndryshimet në legjislacionin për Bujqësi Organike Ligjit Nr. 03/L-042 për bujqësi organike dhe aktet nënligjore përkatëse nuk janë të përafuar me Rregulloren e re të BE-së për prodhimtari organike dhe etiketimin produkteve organike Nr. 2018/848, prandaj korniza aktuale ligjore e Kosovës për bujqësi organike është e pa kompletuar siç parashihet në rregulloret e BE-së, ndërsa kohë pas kohe është plotësuar me udhëzime administratave por të cilat nuk përmbushin nevojat dinamike aktuale të sektorit të bujqësisë organike. Është edhe detyrim që të gjitha vendet jashtë BE-së të përafrojnë ligjet vendore me Rregulloren e re të BE-së Nr. 2018/848. <u>Mangësitë në kornizën aktuale Ligjore të bujqësisë organike</u> 1. Korniza ligjore aktuale e pa harmonizuar.
-----------------------	--

	2. Mungesa e zbatimit të Rregullores së re të BE-së 2018/848, e cila i trajton disa çështje në vijim: • Siguron një kornizë më të qartë për përfshirjen e produkteve shtesë në të ardhmen; • Udhëzimet janë më të qarta lidhur me kriteret për mbetjet e paqëllimshme të pesticideve; • Përfshinë Marrëveshjen e Gjelbër të BE-së dhe Strategjitë Farm to Fork dhe për Biodiversitetin; • Përmirëson transparencën dhe gjurmshmërinë e produkteve organike në të gjithë zinxhirin e furnizimit, si dhe thjeshton sistemin e importit duke u kërkuar vendeve jo anëtare të BE-së që të pajtohen me standardet organike të BE-së. 3. Mungesa e Listës Kombëtare për Inpute Organike 4. Emërtimet që përdoren në etiketimin, materialin reklamues ose dokumentet tregtare për produktet organike. 5. Mungesa e qartësisë në lidhje me trajtimin e produkteve organike të kontaminuara me pesticide që nuk lejohen në bujqësinë organike. 6. Përfshirja e produkteve dhe substancave organike që lejohen të përdoren në prodhimtarin organike. 7. Disa specifika gjatë procesit të konvertimit nga bujqësia konvencionale në bujqësi organike të qëndrueshme me efekte mjedisore që ndikojnë në ndryshimeve klimatike. 8. Rregullimin e kriterëve të produkteve që janë të prodhuara përmes OMGJ-ve. 9. Rregulloret për prodhimin e produkteve të ndryshme nga farërat dhe materiali riprodhuese vegjetative. 10. Kriteret lidhur me përbërjen e ushqimit organik të përpunuar. 11. Rregullat shtesë për delegimin e detyrave të kontrollit zyrtar dhe detyrave që lidhen me veprimtari të tjera zyrtare. 12. Rregullat për importin dhe eksportin e produkteve organike dhe atyre ne konvertim. 13. Mungesa e certifikimit grupor për standardin organik. 14. Mungesa e certifikimit të verërave organike. 15. Përcaktimi i kriterëve lidhur me masat ndaj personave fizik apo juridik të cilët veprojnë në kundërshtim me Ligjin për bujqësi organike.
--	---

Këto ndryshime pasqyrojnë angazhimin e MBPZHR për të siguruar që bujqësia organike të mbetet e qëndrueshme, konkurruese dhe e besueshme, si brenda Kosovës, BE-së ashtu edhe në tregjet globale. Rregullorja e re synon të ofrojë standarde dhe praktika më të qarta, më të qëndrueshme nga të cilat përfitojnë prodhuesit, konsumatorët dhe mjedisi.

SHKAQET

Mos zbatimi i standardeve të kërkuara nga BE-ja sa i përket sistemit të kontrollit në tregun e brendshëm organik, dhe mungesa e kriterëve lidhur me ushqimin organik të përpunuar

Mos zbatimi i standardeve të kërkuara nga BE-ja lidhur me sigurinë e mbrojtjes së shëndetit të njerëzve, kafshëve, mjedisit dhe përmirësimin e funksionimit të tregut të brendshëm, niveleve maksimale të mbetjeve në ushqimin me origjinë bimore dhe shtazore, si dhe mos rregullimi i sistemit për trajnim në bujqësi organike, janë shkaku kryesor i ndikimeve në sistemin e kontrollit në tregun e brendshëm organik.

Ndërsa, në mungesë të kriterëve lidhur me ushqimin organik të përpunuar, operatorët që prodhojnë ushqim organik ose ushqim për kafshë duhet t'i ndjekin procedurat e duhura bazuar në identifikimin sistematik të hapave kritikë të përpunimit, në mënyrë që të sigurohet që produktet e përpunuara të jenë në përputhje me rregullat e prodhimit organik. Produktet organike të përpunuara duhet të prodhohen duke përdorur metoda të përpunimit të cilat garantojnë ruajtjen e karakteristikave dhe cilësive organike të produkteve në të gjitha fazat e prodhimit organik.

Mos përshkrimi i emërtimeve që përdoren në etiketimin, materialin reklamues, ushqimet organik të përpunuara si dhe dokumentet tregtare për produktet organike

Mungesa e bazës ligjore ka shkaktuar mos deklarin e saktë emërtimeve në etiketim, material reklamues ose dokumente tregtare për produktet organike. Është shumë me rëndësi për konsumatorët të kanë sa më shumë informata për produktet organike, por edhe për kompanitë tregtare që tregtojnë produktet organike.

Mungesa e Listës zyrtar për Inpute Organike

Për momentin nuk ekziston Lista e Inputeve Organike që mund të përdorin fermerët gjatë procesit të konvertimit por edhe ata që janë të certifikuar. Para aplikimit të çdo inputi organik fermerët duhet të aplikojnë tek trupa certifikuese dhe në shumicën e rasteve aprovimi për inpute merre kohë shume të gjate. Kjo shkakton probleme të mëdha fermerëve gjatë prodhimit që mund të rezultojnë edhe në humbje të rendimentit. Prandaj me përgatitjen e listës së inputeve organike e sidomos me njohjen e listës së FIBL-it nga trupa certifikuese do të jetë lehtësim shume i madh dhe mundësi e

zgjedhjes e inputeve të ndryshme që të aplikojnë fermerët gjatë kultivimit të kulturave të ndryshme bujqësore. Përmes Listës Inputeve Organike të regjistruara/aprovuar nga organet kompetente fermerët do të kanë më të lehtë procesin e certifikimit me theks të veçantë sa i përket përdorimit të biopesticideve, që për momentin ju shkakton probleme të mëdha gjatë procesit të certifikimit.

Mungesa e kontrolleve dhe inspektimeve rigoroze gjatë procesit të konvertimit dhe certifikimit, dhe mungesa e informacioneve për prodhimin e produkteve të ndryshme nga farërat dhe materiali riprodhues vegetative

Në mungesë të specifikave operatorët duhet të sigurojnë prova se ngastrat e tokës kanë qenë zona natyrore ose bujqësore të cilat për një periudhë të paktën tre vjeçare nuk janë trajtuar me substanca kimike, që nuk janë të autorizuara për përdorim në prodhimin organik. Kjo siguron se toka ku kultivohen produktet organike nuk do të ketë mbetjet të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve (PMB), nëse eventualisht janë përdorur në të kaluarën.

Kjo referohet sidomos për certifikimin grupor, inspektimi i brendshëm që përfshin inspektimin e brendshëm fizike vjetor në fermë dhe inspektimin e çdo anëtarit të grupit. Ndryshime të mëdha në gjetjet midis inspektimeve të brendshme të kryera nga inspektorët e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe kontrolleve zyrtare të kryera nga trupa e kontrollit, dhe informacioneve për prodhimin e produkteve të ndryshme nga farërat dhe materiali riprodhues vegetative.

Prodhimi i produkteve organike të ndryshme nga farërat dhe materiali riprodhues vegetative, materiali riprodhues bimor që nuk i përket një varieteti, por përkundrazi i përket një grupimi bimor brenda një taksoni të vetëm botanik me një nivel të lartë diversiteti gjenetik dhe fenotipik midis njësive riprodhuese individuale, duhet të jetë i disponueshëm për përdorim në prodhimin organik. Përdorimi i materialit riprodhues bimor organik, siç është materiali riprodhues bimor i materialit organik heterogjen dhe të varieteteve organike të përshtatshme për prodhim organik. Për të lehtësuar prodhimin organik në një fazë të hershme të rritjes së bimëve, duhet të lejohet gjithashtu rritja e fidanëve ose transplantët në kontejnerë për transplantim të mëtejshëm.

Mungesa e rregullave shitesë për delegimin e detyrave të kontrollit zyrtar dhe detyrave që lidhen me veprimtari të tjera zyrtare, si dhe mungesa e kontrolleve për produktet e prodhuara përmes Organizmave të Modifikuar Gjenetikisht

Autoritetet kompetente kanë procedura dhe marrëveshje për të siguruar mbikëqyrjen e organeve të kontrollit, duke përfshirë verifikimin që detyrat e deleguara janë kryer në mënyrë efektive, të pavarur dhe objektive, veçanërisht për sa i përket intensitetit dhe shpeshtësisë së verifikimit të përputhshmërisë. Procedura e vlerësimit të rrezikut, e cila do të përcaktojë, në veçanti, bazën për intensitetin dhe shpeshtësinë e verifikimit të përputhshmërisë së operatorëve dhe grupeve të operatorëve.

Ndërsa, mungesë të kontrollit operatorët çdo herë mund të supozojnë se asnjë OMGJ apo produkt i prodhuar nga OMGJ-të nuk është përdorur në prodhimin e ushqimeve dhe ushqimeve të kafshëve, kur këto produkte nuk kanë një etiketë të vendosur ose ofruar, ose nuk shoqërohen me një dokument të dhënë, në përputhje me aktet ligjore të referuara. Andaj, operatorët që përdorin produkte jo organike të blera nga palët e treta do t'i kërkojnë shitësit të konfirmojë që ato produkte nuk janë OMGJ, ose produkte të prodhuara nga OMGJ-të.

Mungesa e informacioneve për importin dhe eksportin e produkteve organike dhe atyre në konvertim

Për të shmangur kontaminimin e produkteve organike ose në konvertim me produkte ose substanca të paautorizuara për përdorim në prodhimin organik, duhet të jetë mundësia për të marr masa të tjera të përshtatshme për të shmangur pranin e produkteve dhe substancave të paautorizuara në bujqësinë organike. Përveç kësaj, është e nevojshme të sigurohet qartësi në lidhje me rregullat e zbatueshme për eksportin e produkteve organike, veçanërisht duke lëshuar certifikata të eksportit organik.

Mungesa e rregullave për certifikimin grupor për standardin organik, dhe përfshirjes së certifikimit të Verërave Organike

Mungesa e disa rregullave specifike të cilat nuk janë të përfshira në legjislacionin aktual të Bujqësisë Organike, paraqet paqartësi në procesin e certifikimit grupor për standardin organik, por dhe në procesin e certifikimit të verërave organike në vendin tonë.

Bazuar në këto rregulla, shumica e vendeve të BE-së por edhe në vende të rajonit, certifikimi i fermerëve bazohet në certifikim grupor, pasi që fermerët të cilën nuk certifikohen në grup paguajnë kosto më të lartë për procesin e certifikimit.

Sa i përket rregullave të prodhimit të verës në shtetet e BE-së, operatorët që prodhojnë produkte nga sektori i verërave duhet të respektojnë, rregullat e detajuara të prodhimit organik të përcaktuara në Rregulloren (BE) 2018/848, në pjesën VI të aneksit II, specifikisht në pikat 3.2 dhe 3.3.

Nivel i pamjaftueshëm i thjeshtimit dhe digjitalizimit

Legjislacioni në fuqi, është pamjaftueshëm i harmonizuar me kërkesat e LPPA, sidomos sa i përket kërkesave si parimi ‘vetëm një herë’, parimi i mos-pagesës por edhe parimet tjera si ofrimi i shërbimeve në kohë. Kjo shkakton kosto shtesë për operatorët.

Për më tepër, deri më tani ka një nivel të ulët të digjitalizimit të shërbimeve në kuadër të këtij ligji, sidomos sa i përket përfshirjes së trupave të kontrollit në listën e trupave të njohur, si dhe sa i përket regjistrimit të operatorëve në sistemin e kontrollit.

Gjithashtu, përkundër faktit të kërkesave të mëdha sa i takon obligimeve për informacion për trupat e kontrollit por edhe për operatorët, prapë se prapë ky informacion nuk shkëmbehet sa duhet në mënyrë digjitale.

Për më tepër, kapacitetet vendore për të kryer funksionet e trupave të kontrollit mbasin ende të ultë, për shkak të kërkesave të larta që imponon legjislacioni vendor dhe ai i BE-së

Mos zbatimi i sanksioneve të shqiptuara nga gjykatat

Regjistrimi i personave fizikë dhe juridikë që angazhohen zyrtarisht në tregtinë e produkteve organike dhe vënia para drejtësisë e atyre që merren me aktivitete të paligjshme, do të ulë sasinë e produkteve organike jo cilësore dhe të dyshimta në treg. Për këtë arsye, kontrole më të rrepta mbi tregun e produkteve organike duhet të zbatohen nga Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinës në bashkëpunim me Institutin Bujqësor të Kosovës të cilat funksionojnë në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

EFEKTET

Ndikim në sistemin e kontrollit në tregun e brendshëm organik

Në mungesë të përafrimit të legjislacionit Nacional me atë të BE-së do të ketë ndikim në sigurinë jo të duhur të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve, kafshëve, mjedisit dhe në përgjithësi përmirësimin e funksionimit të tregut të brendshëm, niveleve maksimale të mbetjeve në ushqimin me origjinë bimore dhe shtazore, si dhe rregullimin e sistemit të trajnimit për Bujqësi Organike për prodhuesit profesionistë, shpërndarësit dhe këshilltarët e kësaj fushe.

Rënie e besueshmërisë së konsumatorëve lidhur me origjinën dhe përmbajtjen e produkteve organike dhe në mos caktimin e kriterëve lidhur me përbërjen e ushqimit organik të përpunuar

Në mungesë të disa emërtimeve që përdoren në etiketimin, materialin reklamues ose dokumentet tregtare për produktet organike, bie besueshmëria e konsumatorëve lidhur me origjinën, përmbajtjen e produkteve organike, por gjithsesi edhe për kompanitë prodhuese dhe tregtare të cilat tregtojnë produktet organike. Ndërsa, në mungesë të rregullimit të kriterëve lidhur me produktet organike të përpunuara, të njëjtat duhet të prodhohen duke përdorur metoda të përpunimit të cilat garantojnë ruajtjen e karakteristikave dhe cilësive organike të produkteve në të gjitha proceset e prodhimit organik.

Mos përfshirja e produkteve që lejohen të përdoren dhe aprovimi i listës së FIBL-it në prodhimtarinë organike dhe vështirësi në certifikimin e fermerëve sipas standardeve të BE-së

Mungesa e bazës ligjore lidhur me Listën e Inputeve Organike ka pamundësuar regjistrimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve organike, si kripën, tapën, dyllin e bletës, gjethet e hardhisë dhe zemrat e palmave që limiton përdorimin e disa produkteve në bujqësi organike, dhe si rrjedhojë e kësaj edhe kufizimin e numrit të subjekteve të cilat merren me prodhimtari organike. Përmes listës inputeve organike fermerët do ta kishin më të lehtë “procesin e certifikimit”, me theks të

veçantë përdorimit të biopesticideve të cilat për momentin ju shkakton probleme të mëdha gjatë procesi.

Besueshmëria gjatë procesit të konvertimit dhe certifikimit, dhe paqartësitë tek prodhuesit e sektorit të Bujqësisë Organike të cilët produktet e tyre i përfitojnë nga farërat dhe materiali riprodhues vegjetativ

Mungesa e disa specifikave gjatë procesit të konvertimit e vështirëson sigurinë e vlerësimit të tokave ku kultivohen produktet organike të cilat nuk duhet të ketë mbetje kimike nëse eventualisht janë përdorur në të kaluarën. Prandaj, pas një periudhe të përshtatshme konvertimi, njësitë bujqësore në vend që synojnë të bëhen organike duhet të menaxhohen tërësisht në përputhje me kërkesat e zbatueshme për prodhimin organik.

Sa i për ketë paqartësi tek prodhuesit e sektorit të Bujqësisë Organike të cilët produktet e tyre i përfitojnë nga farërat dhe materiali riprodhues vegjetativ, kjo do të siguron se materiali riprodhues bimor posedon diversitetin e lartë gjenetik dhe fenotipik dhe duhet të jetë i disponueshëm për përdorim në prodhimin organik. Përdorimi i farave me një shkallë të lartë diversitetin gjenetik, rezistencë ndaj sëmundjeve dhe jetëgjatësisë siguron certifikim më të lehtë.

Vështirësi në mbikëqyrjen e organeve të kontrollit për verifikimin e përputhshmërisë, dhe në identifikimin e produkteve të prodhuara nga Organizmat e Modifikuar Gjenetikisht

Në mungesë për të mbështetur kryerjen e kontrolleve zyrtare dhe aktiviteteve të tjera zyrtare për të verifikuar pajtueshmërinë me rregullore përkatëse, kompetenca për miratimin e akteve të caktuara duhet t'i delegohet Komisionit në lidhje me kushtet për delegimin e detyrave të kontrollit zyrtar dhe detyrave që lidhen me zyrtarë të tjerë për aktivitetet për organet e kontrollit.

Sa i përket Organizmave të Modifikuar Gjenetikisht (OMGJ), duhet theksuar se në Kosovë nuk është i lejuar përdorimi i tyre apo produktet e prodhuara prej tyre, të cilat do të mund të përdoren si ushqim për njerëz dhe kafshë, ose produkte ndihmëse për përpunimin, produkte për mbrojtjen e bimëve, plehërues, kondicionerë të tokës, materiale riprodhuese bimore, mikroorganizma ose kafshë në prodhimin organik. Andaj, mos identifikimi i OMGJ-ve krijon pasiguri rreth cilësisë së produkteve në përgjithësi, veçanërisht tek produktet organike të cilat duhet të jenë të sigurta për konsumatorët që nuk dëshirojnë të konsumojnë produkte të prodhuara përmes OMGJ-ve.

Vështirësi në importin dhe eksportin e produkteve organike

Produktet organike nuk mund të kenë praninë e produkteve dhe substancave të paautorizuara që kërkohet sipas standardeve të bujqësisë organike. Është shumë e nevojshme për t'ju përgjigjur pritshmërisë së konsumatorëve që produktet organike të importuara plotësojnë standarde të larta dhe për të siguruar më mirë aksesin e produkteve organike të vendit në tregun ndërkombëtar. Përveç kësaj, është e nevojshme të sigurohet qartësi në lidhje me rregullat e zbatueshme për eksportin e produkteve organike, veçanërisht duke vendosur certifikata të eksportit organik.

Pamundësi e fermerëve të certifikohen në grup dhe pamundësi e certifikimit të Verërave Organike

Kjo gjë ju shkakton fermerëve kosto më të lartë të certifikimit, megjithatë ekziston një theks në certifikimin në grup për fermerët në shkallë të vogël për të reduktuar barrën administrative dhe kostot e tyre. Ndërsa në pamundësi të certifikimit, verërat organike nuk mund t'i nënshtrohet rregullave përkatëse për ushqimin organik të përpunuar. Megjithatë, duke qenë se vera është një kategori specifike dhe e rëndësishme e produkteve organike, rregullat shtesë të detajuara të prodhimit duhet të përcaktohen posaçërisht për “verën organike”. Vera organike duhet të prodhohet tërësisht nga lënda e parë organike dhe duhet të lejohen të shtohen vetëm disa produkte dhe substanca të autorizuara në përputhje me këtë rregullore. Përdorimi i disa praktikave, proceseve dhe trajtimeve enologjike në prodhimin e verës organike duhet të ndalohet. Praktikrat, proceset dhe trajtimet e tjera duhet të lejohen në kushte të përcaktuara mirë sipas Rregullores (BE) 2018/848, e cila në të ardhmen do të jetë e zbatueshme edhe në vendin tonë.

Barra administrative e lartë për operatorët

Vështirësitë në harmonizim me kërkesat për uljen e barrës administrative, siç janë thjeshtimi sipas kërkesave të LPPA, si dhe digjitalizimi i shërbimeve dhe shkëmbimit të informacionit, shkakton kosto shtesë për trupat e kontrollit, dhe në këtë mënyrë edhe për operatorët. Barra administrative u shtohet operatorëve edhe për shkak të kapaciteteve jo të mjaftueshme vendore për të kryer funksionet e trupit të kontrollit.

Masat ndaj personave fizik apo juridik të cilët veprojnë në kundërshtim me Ligjin për Bujqësi Organike

Regjistrimi i personave fizikë dhe juridikë që angazhohen zyrtarisht në tregtinë e produkteve organike dhe vënia para drejtësisë e atyre që merren me aktivitete të paligjshme, do të ulë sasinë e produkteve organike jo cilësore dhe të dyshimta në treg. Për këtë arsye, kontrolle më të rrepta mbi tregun e produkteve organike duhet të zbatohen nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës në bashkëpunim me Institutin Bujqësor të Kosovës të cilat funksionojnë në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Palët me interes – (përditësohet pas definimit të saktë të shkaqeve dhe efekteve)

Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit

Emri i palës së interesuar	Shkaku/qet me të cilat është e lidhur pala	Efkti/et me të cilat është e lidhur pala	Mënyra me të cilën pala është e lidhur me këtë shkak (shkaqe) apo efektin (efektet)
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	Mos zbatimi i standardeve të kërkuara nga BE-ja sa i përket sistemit të kontrollit në tregun e brendshëm organik dhe mungesa e kriterëve lidhur me ushqimin organik të përpunuar. Mungesa e disa emërtimeve që përdoren në etiketimin, materialin reklamues, ushqimet organik të përpunuara si dhe dokumentet tregtare për produktet organike	1. Ndikim në sistemin e kontrollit në tregun e brendshëm organik. 2. Rënie e besueshmërisë së konsumatorëve lidhur me origjinën dhe përmbajtjen e produkteve organike dhe në mos caktimin e kriterëve lidhur me përbërjen e ushqimit organik të përpunuar. Mos përfshirja e produkteve që lejohen të përdoren dhe aprovimi i listës së FIBL-it në	MBPZHR-përgjegjëse për hartimin e politikave dhe legjislacionit lidhur me Bujqësinë Organike

	3. Mungesa e Listës Kombëtare të Inputeve Organike dhe Listës së FIBL-it (Lista e Inputeve Organike/ Instituti Zviceranë i Hulumtimeve për Kontroll Biologjike).	prodhimtarinë organike dhe vështirësi në certifikimin e fermerëve sipas standardeve të BE-së.	
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR); Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinës (AUV); Instituti Bujqësor i Kosovës (IBK);	Mungesa e kontrolleve dhe inspektimeve rigorozë gjatë procesit të konvertimit dhe certifikimit, dhe mungesa e informacioneve për prodhimin e produkteve të ndryshme nga farërat dhe materiali riprodhues vegjetative.	4. Besueshmëria gjatë procesit të konvertimit dhe certifikimit, dhe paqartësitë tek prodhuesit e sektorit të Bujqësisë Organike të cilët produktet e tyre i përfitojnë nga farërat dhe materiali riprodhues vegjetativ.	MBPZHR- përgjegjëse për hartimin e politikave për përcaktimin e rregullave shtesë për delegimin e detyrave të kontrollit zyrtar, dhe detyrave tjera që lidhen me veprimtari tjera zyrtare;
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)	5. Mungesa e rregullave shtesë për delegimin e detyrave të kontrollit zyrtar dhe detyrave që lidhen me veprimtari të tjera zyrtare, si dhe mungesa e kontrolleve për produktet e prodhuara përmes Organizmave të Modifikuar Gjenetikisht (OMGJ).	5. Vështirësi në mbikëqyrjen e organeve të kontrollit për verifikimin e përputhshmërisë, por edhe identifikimin e produkteve të prodhuara nga Organizmat e Modifikuar Gjenetikisht (OMGJ).	AUV- është përgjegjës për realizimin e kontrolleve dhe inspektimeve gjatë proceseve të certifikimit; IBK- përgjegjëse për realizimin e analizave laboratorike për PMB, farërave, fidanëve, tokës, sëmundjet dhe dëmtuesit, si dhe identifikimin e OMGJ-ve; MMPHI- përgjegjëse për furnizimin e të dhënave

			meteorologjike dhe çështjet ambientale.
Dogana e Kosovës, Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinës	6. Mungesa e informacioneve për importin dhe eksportin e produkteve organike dhe atyre në konvertim.	6. Vështirësi në importin dhe eksportin e produkteve organike.	Dogana dhe AUV- përgjegjëse për realizimin e kontrolleve, inspektimeve dhe mbajtjen e informacioneve të importit dhe eksportit.

MBPZHR, Shoqatat e Bujqësisë Organike, dhe operatorët tjerë	7. Mungesa e rregullave për certifikimin grupor për standardin organik dhe përfshirjes se certifikimit te verërave organike.	7. Pamundësi e fermerëve të certifikohen në grup dhe pamundësi e certifikimit te Verërave Organike.	MBPZHR- përgjegjëse për përcaktimin e rregullave të certifikimit grupor, ndërsa shoqatat dhe operatorët tjerë - përgjegjëse për zbatimin e rregullave për certifikim grupor në Bujqësinë Organike.
Ministria e Drejtësisë dhe MBPZHR	8. Mos zbatimi i sanksioneve nga gjykatat.	8. Masat ndaj personave fizik apo juridik të cilët veprojnë në kundërshtim me Ligjin për Bujqësi Organike.	Ministria e Drejtësisë dhe MBPZHR- është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe legjislacionit lidhur masat ndaj personave fizik apo juridik të cilët veprojnë në kundërshtim me Ligjin.

Praktikat e vendeve të rajonit, të cilat mund të gjejnë zbatim në Republikën e Kosovës dhe të cilat do të merren parasysh gjatë hartimit të Ligjit të ri janë:

Praktikat e vendeve të BE-së – Rregullorja e BE-së, Nr. 2018/848 për Prodhimin Organik dhe Etiketimin e Produkteve Organike, njëzet e shtatë (27) vendet e Bashkimit Evropian kanë filluar të aplikojnë nga 1 Janar 2022. (Rregullorja e re (KE) 2018/848 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 30 maj 2018 për prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 834/2007. Numri CELEX: 32018R0848, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L 150, Dt.14.6.2018, faqe. 1–9)..

Bazuar në **Rregullores e re të BE-së Nr. 2018/848** janë të përcaktuara parimet dhe rregullat për prodhimin organik lidhur me certifikimin dhe përdorimin e treguesve që i referohen prodhimit organik në etiketim dhe reklamim dhe rregullat për kontrollin zyrtar, që të sigurojë bazën për zhvillimin e qëndrueshëm të prodhimit organik, funksionimin efikas të tregut të brendshëm dhe

garantimin e konkurrencës së drejtë, besimin dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, në përputhje me harmonizimin e legjislacionit të BE-së.

Përmes rregullores së BE-së (Nr.2018/848) për Prodhimin Organik dhe Etiketimin e Produkteve Organike synon të arrihen disa objektiva:

- Të kontribuojë për mbrojtjen e mjedisit dhe klimës;
- Të ruajë pjellorinë afatgjatë të tokës dhe të kontribuojë për një nivel të lartë biodiversitetit;
- Të kontribuojë për standarde të larta të mirëqenies së kafshëve dhe të nxisë ruajtjen e racave të rralla dhe autoktone në rrezik zhdukje;
- Të nxisë zinxhirin e shkurtër të shpërndarjes dhe prodhimit lokal në zona të ndryshme të vendit;
- Të rritë prodhimin e produkteve ushqimore me cilësi të lartë.

Rregullorja Nr.2018/848 zbatohet për produktet me origjinë nga bujqësia, përfshirë akuakulturën, bletarinë dhe produktet e prejardhura prej tyre, kur këto produkte prodhohen, ose synohen të prodhohen, përgatiten, etiketohen, shpërndahen, vendosen në treg dhe importohen ose eksportohen, si më poshtë:

- a) Produkte bujqësore të gjalla ose të papërpunuara, përfshirë farat dhe materiale të tjera mbjellëse dhe shumëzuese bimore;
- b) Produkte bujqësore të përpunuara për t'u përdorur si ushqim;
- c) Ushqime për kafshë;
- d) Produkte të tjera të lidhura ngushtë me bujqësinë, nëse ato prodhohen ose synohen të prodhohen, përgatiten, etiketohen, shpërndahen, vendosen në treg, importohen ose eksportohen në vendet e BE-s si dhe në vendet e treta.

Rregullorja e BE-së Nr.2015/848

Kapitulli I - Përcakton qëllimin e këtij projektligji, fusha e zbatimit dhe përkufizimet në kuptim të këtij ligji. Tek fusha e zbatimit përfshihen edhe produkte të tjera të lidhura ngushtë me bujqësinë, të përcaktuara në Aneksin I, të Rregullores 848/2018, të cilat parashikohen të përcaktohen me të ministrin. Gjithashtu, sipas nenin 2, pika 6 duhet shtuar kërkesa që produktet organike të prodhuara dhe përgatitura në Kosovë dhe që synohen të vendosen në tregun kosovar, duhet të certifikohen

sipas rregullave të këtij ligji, për të shmangur problematikën e identifikuar gjatë zbatimit të ligjit ekzistues, që produktet e certifikuara për eksport sipas standardeve të tjera nga ky ligj, nëse vendosen në tregun vendor duhet të certifikohen edhe sipas këtij ligji dhe të përmbajnë logon kombëtare.

Kapitulli II - Përcakton objektivat dhe parimet e përgjithshme dhe të veçanta për prodhimin organik.

Kapitulli III - Përcakton rregullat e prodhimit:

- **Rregullat e përgjithshme të prodhimit**, nenet 9, 10 dhe 11, për lejimin e përdorimit në prodhimin organik vetëm të produkteve dhe substancave të përcaktuara në nenet 22, 23 dhe 24, ndalimin e përdorimit të OMGJ-ve dhe të rrezatimit jonizues në prodhimin organik etj.
- **Rregullat e hollësishme të prodhimit**, sipas llojit të prodhimit bimor, blegtoral, akuakulturës, i përpunuar etj. parashikohen në nenet 13-18 të këtij ligji, të cilat do të përafrojnë Aneksin II të Rregullores (KE) 2018/848 dhe rregullore të tjera deleguese dhe implementuese, në zbatim të Rregullores (KE) 2018/848 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 30 maj 2018 për prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 834/2007.
- **Në nenin 20**, parashikohen përjashtimet nga rregullat e prodhimit organik, kur si pasojë e fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera kanë ndodhur ngjarje katastrofike, që e bëjnë të pamundur përmbushjen e rregullave të prodhimit. Përjashtimet miratohen nga Komisioni për Bujqësi Organik (KBO) për një periudhë të kufizuar, derisa prodhimi organik të mund të rikthehet në kushte normale. Kriteret e përcaktimit të një situate si “ngjarje katastrofike” ose çdo situatë e krahasueshme, rregullat dhe procedurat e KBO-së për miratimin e përjashtimeve nga rregullat e prodhimit, si dhe rregullat për monitorimin dhe raportimin në raste të tilla, do të miratohen me urdhër të ministrit, në përputhje me rregulloren implementuese të Komisionit Evropian.
- **Në nenin 21**, përcaktohen rregullat e përgjithshme për grumbullimin, ambalazhimin, transportin dhe ruajtjen e produkteve organike, ndërsa rregullat e hollësishme do të përcaktohen me udhëzim administrative, të cilat do të përafrojnë Aneksin III të Rregullores 848/2018.

- Produktet dhe substancat që përdoren në prodhimin organik (**nenet 22-24**), përkatësisht:
 - Lista e produkteve dhe substancave që përdoren në prodhimin organik (lëndëve vepruese në përbërje të PMB dhe PP), që miratohet me urdhër të ministrit (pika 4, neni 22), duke përafruar plotësisht listën e BE-së, të përcaktuar në Rregulloren implementuese (KE) 1165/2021.
 - Lista pozitive e PMB-ve dhe PP, që duhet të kenë në përmbajtje të tyre produktet dhe substancat e miratuara sipas pikës 4, neni 22, që përdoren në prodhimin organik, do të miratohen nga komisionet ekzistuese në Ministri, për regjistrimin e PMB-ve dhe PP që përdoren në bujqësinë konvencionale, sipas legjislacionit në fuqi për PMB dhe PP.
 - Lista e produkteve dhe substancave që përdoren në prodhimin e ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë, të përpunuara dhe majave, miratohet me urdhër të ministrit (pika 3, neni 23), duke u përafruar plotësisht me listën e BE-së duke përafruar plotësisht listën e BE-së, të përcaktuar në Rregulloren implementuese (KE) 1165/2021.
- **Në nenin 24**, parashikohet procedura për miratimin nga KBO, të përdorimit të përkohshëm të përbërësve bujqësorë joorganikë për prodhimin e ushqimeve organike të përpunuara, të tjerë nga ata të përcaktuar në listën sipas pikës 3, neni 23, në rastin kur përbërës të caktuar bujqësorë nuk gjenden në formë organike në sasi të mjaftueshme. Këto përbërës bujqësorë joorganikë duhet të jenë të miratuar për përdorim të përkohshëm nga të paktën një vend anëtar i Bashkimit Evropian (lista në faqen zyrtare të BE-së).
- **Neni 25**, përcakton ngritjen e një sistemi që mundëson, operatorët që tregtojnë, të bëjnë publike në bazë vullnetare, informacionin mbi materialin mbjellës dhe shumëzues bimor organik ose në kalim, kafshët organike ose rasat peshku organik në akuakulturës, që janë në gjendje t'i furnizojnë ato në sasi të mjaftueshme dhe brenda një kohe të arsyeshme.

Kapitulli IV - Përcakton rregullat për etiketimin e produkteve organike:

- Parashikon rregullat për përdorimin e termave që i referohen prodhimit organik (termi "organik" ose "biologjik" dhe shkurtimet, si "bio" ose "eko") në etiketimin, reklamimin ose dokumentet tregtare të produktit organik që plotëson kërkesat e ligjit. Ligji parashikon ndalimin e përdorimit në etiketim, reklamim, ose në dokumentet tregtare, i termave që i referohen prodhimit organik të një produkti i cili nuk është në përputhje me kërkesat e ligjit. Gjithashtu, termat që i referohen prodhimit organik nuk mund të përdoren si markë tregtare, emra të kompanisë, njësive të shitjes, ose praktika të tjera të përdorura në etiketim ose

reklamim, që mund të keq informojnë ose mashtrojnë konsumatorin ose përdoruesin duke sugjeruar se një produkt ose përbërësit e tij plotësojnë kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.

- Në **nenet 30-31** janë përcaktuar rregullat për etiketimin e produkteve në kalim dhe ushqimeve organike të përpunuara.
- **Neni 32**, përcakton që produktet dhe substancat e përdorura në PMB dhe PP, të miratuara për t'u përdorur në prodhimin organik, mund të mbartin një referencë që tregon se janë të lejuara të përdoren për prodhimin organik në përputhje me ligjin.
- **Neni 33**, përcakton treguesit e detyrueshëm që duhet të vendosen në etiketimin e produkteve organike.
- Në **nenin 34**, përcaktohet kur përdoret logoja kombëtare e prodhimit organik, në etiketimin, paraqitjen dhe reklamimin e produkteve të prodhuara në vend, të cilat plotësojnë kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe që vendosen në tregun vendor.

Logo evropiane për prodhimin organik mund të përdoret në etiketimin, paraqitjen dhe reklamimin e produkteve të importuara në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kapitullin VII të këtij ligji.

Kapitulli V - Përcakton rregullat për certifikimin e produkteve organike.

- Në **nenet 35-37**, përcaktohet procedura për regjistrimin e aktivitetit tek autoriteti kompetent përkatës për kontrollin zyrtar, përpara vendosjes në treg të produktit si organik ose në konvertim, nga operatorët dhe grupi i operatorëve, të cilët prodhojnë, përgatisin, shpërndajnë ose ruajnë produkte organike ose në konvertim, importojnë ose eksportojnë, ose vendosin në treg produkte të tilla.
- **Neni 38** përcakton rregullat e pajisjes me certifikatë zyrtare të çdo operatori ose grup operatorësh që kanë regjistruar aktivitetin dhe është në përputhje me kërkesat e këtij ligji.
- Certifikimi i grupor i operatorëve (**neni 39**) është një dispozitë e re edhe për BE-në e cila i jep mundësi fermerëve të vegjël të certifikohen si grup, duke ulur kostot e certifikimit individual. Rregullat lidhur me përbërjen dhe funksionimin e grupit të operatorëve parashikohen të miratohen me udhëzim administrative.

Kapitulli VI - Përcakton rregullat për kontrollet zyrtare dhe aktivitetet e tjera zyrtare. Në këtë kapitull përcaktohen rregullat e veçanta që duhet të zbatohen për kryerjen e kontrolleve zyrtare përveç rregullave të përgjithshme të përcaktuara në legjislacionin për kontrollet zyrtare dhe

veprimtari të tjera zyrtare lidhur me ushqimin dhe ushqimin për kafshë, shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve si dhe shëndetin e bimëve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve.

- Në **nenet 42-45**, përcaktohen kontrollet zyrtare që kryhen për verifikimin e përputhshmërisë me këtë ligj dhe veprimet që merren nga autoritetet kompetente përkatëse të kontrollit zyrtar ose trupa e kontrollit, vlerësimi i riskut, dokumentacioni i kontrolleve zyrtare dhe detyrimet e operatorëve dhe grupet e operatorëve për kontrollet zyrtare.
- Në **nenin 46** përcaktohen detyrat e trupave të kontrollit për kryerjen e kontrollit zyrtar të specializuar për qëllim certifikimin e operatorit ose grup operatorëve.
- **Neni 47**, KBO është përgjegjës edhe për miratimin e përjashtimeve nga rregullat e prodhimit organik (neni 20), miratimin e përdorimit të përbërësve bujqësorë joorganikë për ushqimet organike të përpunuara (neni 24) dhe për shqyrtimin e ankesave ndaj masave administrative të vendosura ndaj operatorit, grup operatorëve dhe trupës së kontrollit nga autoritetet kompetente të kontrollit zyrtar.
- **Neni 48** parashikon që, pas miratimit, trupat e kontrollit duhet të mbikëqyren/auditohen nëse kryejnë detyrat e caktuara sipas këtij ligji. Autoriteti mbikëqyrës i trupave të kontrollit është autoriteti kompetent për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë e cila bashkëpunon me autoritetet kompetente të kontrollit zyrtar të prodhimit primar në fermë bujqësore
- Në çdo rast mbikëqyrja e trupave të kontrollit duhet të shmangë mbivendosjen me mbikëqyrjen e kryer nga organizimi akreditues.
- Në **nenet 49-50**, parashikohen masat për pezullimin dhe shfuqizimin e miratimit të trupave të kontrollit, që certifikojnë sipas kërkesave të këtij ligji. Ministria, në bazë të propozimit të KBO-së vendos mbi vlefshmërinë e certifikatave të lëshuara nga trupat e kontrollit përpara datës së këtij pezullimi ose shfuqizimit dhe informon operatorët për vendimin.
- **Neni 51** përcakton informacionet dhe periudhën e raportimit që duhet të paraqesë trupa e kontrollit në Ministri dhe tek autoritetet e tjera kompetente të kontrollit zyrtar.
- Në **nenet 52-53**, përcaktohen masat që duhet të merren nga trupat e kontrollit ose autoritetet kompetente përkatëse të kontrollit zyrtar, në rast të mospërputhjeve të dyshuara ose që cenojnë integritetin organik të produktit.
- **Neni 54** përcakton rregullat e shkëmbimit të informacionit midis autoriteteve kompetente të kontrollit zyrtar dhe trupat e kontrollit me Ministrinë dhe me autoritetet kompetente të vendeve

të tjera, për një dyshim për mospërputhje që cenon integritetin e produkteve organike ose në konvertim.

Kapitullin VII - Përcakton rregullat për eksportin dhe importin e produkteve organike me vendet e tjera. Në Rregulloren (KE) 2018/848 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 30 maj 2018 për prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike, përcaktohen kushtet për importin në BE, dhe vendeve të treta duhet të krijojë një regjim importi duke e përshtatur me atë të BE-së.

- Në **nenin 55**, përcaktohen kushtet për eksportin e produkteve organike, nëse plotëson kushtet e vendit ku eksportohet. Produktet që eksportohen mund të mbajnë logon kombëtare për prodhimin organik, nëse plotësojnë rregullat e përcaktuara në këtë ligj.
- **Neni 56**, përcakton kushtet e importit të produkteve organike dhe në konvertim, kur ato konsiderohen në përputhje me këtë ligj, sipas rastit kur importohen nga BE, ose nga vende të treta, përkatësisht kur:
 - ✓ Produkti vjen nga vendet anëtare të BE-së dhe shoqërohet me certifikatën e operatorit e cila konfirmon se produkti është në përputhje me rregullat e BE-së për prodhimin organik;
 - ✓ Produkti vjen nga një vend i tretë, dhe është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kreun II, III, IV dhe V të ligjit dhe të gjithë operatorët dhe grupet e operatorëve përfshirë eksportuesit në vendin e tretë, i janë nënshtruar kontrolleve nga trupat e kontrollit ose autoritetet e kontrollit të njohura nga Komisioni Evropian si të përputhura për importin e produkteve organike në BE, dhe këto trupa kontrolli kanë pajisur të gjithë këta operatorë, grupe të operatorëve dhe eksportues me një certifikatë ku vërtetohet se ata janë në përputhje me rregullat e BE-së për prodhimin organik dhe ngarkesa shoqërohet me certifikatën e inspektimit;
 - ✓ Produkti vjen nga një vend i tretë, i cili është njohur si ekuivalent ose në përputhje me marrëveshje tregtare me BE-në, për importin e produkteve organike në Bashkimin Evropian, dhe produkti përputhet me rregullat e prodhimit dhe kontrollit të atij vendi të tretë, të cilat janë ekuivalente me këtë ligj, dhe importohet me një certifikatë inspektimi të lëshuar nga autoritetet kompetente, autoritetet e kontrollit ose trupat e kontrollit të vendit të tretë;
- **Neni 57** përcakton që kontrolli i përputhshmërisë me kushtet dhe masat për importin e produkteve organike dhe në kalim, kryhet nga autoriteti i kontrollit dhe autoriteti doganor, në pikat e inspektimit kufitar. Është dakorduar me autoritetin doganor (pjesë e grupit të punës në hartimin e ligjit) që të shtohet nomenklatura për diferencimin në doganë të produkteve organike

nga ato joorganike, me qëllim që të sigurohet informacioni mbi produktet organike të importuara dhe të eksportuara. Në projektligj përcaktohet që dogana duhet të paraqesë në Ministri një raport vjetor për produktet organike të eksportuara dhe të importuara, deri më 1 mars të çdo viti, për vitin paraardhës (neni 57).

Kapitulli VIII - Përcakton kundërvajtjet administrative dhe sanksionet ndaj operatorëve organikë dhe trupave të kontrollit (nenet 58-59), duke specifikuar dhe përgjegjësitë administrative sipas neneve përkatëse.

Kapitulli IX - Përcakton dispozitat kalimtare dhe të fundit, në lidhje me miratimin e akteve nënligjore dhe vijimin e funksionimit të KBO-së aktuale si dhe vijimi i procedurave të miratimit të trupave të kontrollit sipas Ligjit të Ri deri në miratimin e akteve nënligjore përkatëse.

Kapitulli 2: Objektivat

Objektivat relevante të Qeverisë

Qëllimi i përgjithshëm Objektivi strategjik dhe Objektivat specifike:

Siç është paraparë nga MSA-ja, Kosova ka zhvilluar Programin Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE) si një dokument kryesor strategjik kombëtar për planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të gjitha reformave të nevojshme për zbatimin e MSA-së dhe fazat e ardhshme të anëtarësimit në BE. PKIE për vitet 2024-2028 përcakton një kornizë gjithëpërfshirës afatmesëm të gjitha reformave të kërkuara për të përmbushur detyrimet që dalin nga MSA, përkatësisht masat dhe prioritetet e kërkuara për përafrimin gradual të legjislacionit kombëtar me acquis të BE-së, duke e transpozuar këtë të fundit në legjislacionin kombëtar, dhe zbatimin e legjislacionit të përafërt. BE merr gjithashtu parasysh rekomandimet e dhëna çdo vit nga raportet e KE-së dhe për këtë arsye njeh rëndësinë e qasjes së integruar për sigurinë ushqimore që synon të sigurojë një nivel të lartë të sigurisë ushqimore, shëndetit të kafshëve, mirëqenies së kafshëve dhe shëndetit të bimëve. Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025 është dokumenti bazë përmes të cilit Qeveria ua komunikon vizionin qytetarëve të Republikës së Kosovës në lidhje me qeverisjen e saj. Ai pasqyron qasjen dhe parimet që duhen ndjekur gjatë gjithë qeverisjes, si dhe prioritetet dhe nismat bazë që do të ndërmerren në të gjitha fushat për përmirësimin e situatës në vend. Ky program pasqyron orientimet e përgjithshme në lidhje me agjendën e integritit evropian dhe politikën e jashtme. Ai transmeton frymën demokratike dhe pluraliste të vendit, e cila siguron përfundimin e procesit të shtet ndërtimit dhe integrimin e plotë të Republikës së Kosovës në

institucionet rajonale, evropiane dhe ndërkombëtare. Sipas Programit Qeveritar 2021-2025 objektivi është avancimi i politikave të sigurisë ushqimore dhe harmonizimi i tyre me standardet e BE-së, të cilat synojnë të sigurojnë një nivel të lartë të sigurisë së ushqimit, shëndetit të kafshëve dhe shëndetit të bimëve. Në këtë drejtim, përveç tjerash prioritet do t'i jepet hartimit të kornizës ligjore për bujqësi organike.

Qëllimet e politikave dhe objektivat strategjikë janë tashmë të parapërcaktuar në dokumentet strategjike qeveritare, ndërsa objektivat specifike janë rezultat i përcaktimit të detajuar të problemit siç përshkruhet në Kapitullin 2 të këtij dokumenti, pasi ato përcaktojnë objektivat konkrete që duhen arritur.

Klasifikimi SMART i objektivit të përgjithshëm përshkruhet në tabelën e mëposhtme:

SMART	Përshkrimi
Specifika	Objektivi i përgjithshëm është avancimi i politikave të sigurisë së ushqimit dhe harmonizimi i tyre me standardet e BE-së me qëllim të sigurimit të një niveli të lartë të sigurisë së ushqimit, shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe mbrojtjes së mjedisit duke adresuar përafrimin saktësisht konkret të legjislacionit kombëtar të Kosovës me Rregulloren (BE) Nr. Nr. 2018/848
Të matshme	Miratimi i Ligjit të ri nga Kuvendi dhe publikimi i tij në Gazetën Zyrtare të RKS-së, bazuar në Rregulloren e BE - së Nr. Nr. 2018/848
E arritshme	Objektivi i përgjithshëm pritet të arrihet përmes kapaciteteve juridike dhe politike të institucioneve relevante qeveritare dhe Kuvendit të Kosovës.
Relevante	Rëndësia e Bujqësisë organike shpjegohet në kapitujt 1 dhe 2 të këtij dokumenti. Objektivi i përgjithshëm mbështet sektorin e bujqësisë organike të Kosovës në kërkimin e tij drejt konkurrencës dhe tregut të sigurt të produkteve organike.
I kufizuar në kohë	Afati kohor përcaktohet nga procedurat, koha e nevojshme për finalizimin e koncept dokumentit si dhe koha e nevojshme për hartimin, diskutimin, finalizimin dhe miratimin e ligjit të ri bazuar në Rregulloren (BE) Nr. Nr. 2018/848 nga institucionet përkatëse sipas rregullave në fuqi në RKS.

Qëllimi i përgjithshëm i politikës – Avancimi i politikave të bujqësisë organike në prodhimtarinë bujqësore për të siguruar prosperitet ekonomik të vendit	
Objektivi strategjik: Avancimi i politikave për siguri ushqimore dhe përafrimi i tyre me standardet e BE-së, të cilat synojnë të sigurojnë një nivel të lartë të ushqimit për njeriun, mjedisin dhe shëndetin e bimëve përmes bujqësisë organike. Objektivat specifike: - Regjistrimi, importimi, ruajtja dhe vendosja në treg e PMB-ve organike të bëhet sipas legjislacionit të BE-së. - Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e Ligjit për bujqësisë organike. - Mbrojtja e fermerëve vendor nga importimi dhe tregtimi i produkteve organike jo cilësore dhe ngritja e vetëdijes për rolin dhe rëndësinë bujqësisë organike. - Krijimi i sistemit për trajnime të detyrueshme për fermerët që prodhojnë sipas standardeve organike. - Pajisjet për përdorim profesional për aplikimin e PMB-ve organike, të regjistruhen dhe të inspektohen në intervale të rregullta, në mënyrë që të arrihet niveli i lartë i mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe mjedisit - Përpjekje të rritura për zvogëlimin e barrës administrative për fermerët - Ngritja e kapaciteteve për Institucionet relevante, gjyqtarët dhe përmbauesit.	• Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025 2.10. Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural 2.10.5 Siguria e ushqimit Plani Kombëtar për Zhvillim Qëllimi zhvillimor dhe qëllimi strategjik: • 1.9 Ndërtimi i lidhjeve të qëndrueshme në mes të fermerëve, përpunuesve dhe shitësve me pakicë; • Masa Strategjike: Përmirësimi i pozitës së fermerëve në zinxhirin e vlerës; • Aktivitetet– Hartimi i Koncept Dokumentit për Bujqësi Organike; Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030 Shtylla e I – Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik: Qëllimi Zhvillimor: Ekonomi digjitale, qarkore dhe konkurruese: Qëllimi Strategjik: 1.9 Ndërtimi i lidhjeve të qëndrueshme mes fermerëve, përpunuesve e shitësve me pakicë.
Objektivat specifike Opsioni 2: • Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e Ligjit,	Të hartuara për nevojat e këtij KD

• Mbrojtja e shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe mjedisit, • Ngritja e vetëdijes për rëndësinë e bujqësisë organike, • Rritja e buxhetit për trajnimin e këshilltarë dhe inspektorëve fitosanitar për bujqësi organike, • Koordinim më i mirë ndërinstitutional në mes MBPZHR, IBK-së, AUV-it, Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë (FBV), Doganës, Kompanive, si dhe Shoqatave Importuese-tregtuese të produkteve organike me qëllim harmonizimin dhe avancimin e politikave për sektorin e bujqësisë organike, • Vetëdijesimin e fermerëve përmes organizimit të kampanjës dhe sensibilizimit të institucioneve përgjegjëse, mbi rolin e sektorit të bujqësisë organike.	
Objektivat specifike Opsioni 3: - Harmonizimi/përafrimi me Rregulloren e BE-së për Bujqësinë Organike Nr. 2018/848. - Përforcimi i sistemit të kontrollit nga autoritetet përgjegjëse për zbatimin e rregullave për certifikim të produkteve organike, dhe realizimin e testeve laboratorike për mbetjet e Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve tek produktet organike. - Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e Ligjit dhe inspektimi i produkteve organike pas regjistrimit të tyre në Listën Nacionale të Produkteve Organike. - Mbrojtja e fermerëve vendor nga importimi dhe tregtimi i produkteve jo	Të hartuara për nevojat e këtij KD

cilësore dhe ngritja e vetëdijes për rolin dhe rëndësinë e produkteve organike. - Regjistrimi, importimi, ruajtja dhe vendosja në treg e PMB-ve organike të bëhet sipas legjislacionit të BE-së.	
--	--

Kapitulli 3: Opsionet

Në këtë Koncept Dokument janë paraqitur tri opsione duke filluar me përshkrimin e gjendjes aktuale pa ndonjë ndryshim në zbatimin e kornizës ligjore në fuqi. Ndërsa, duke parë gjendjen e tanishme në zbatimin e kornizës ligjore për Bujqësi Organike jemi përpjekur që përmes identifikimit të nevojave për avancim të ligjit vetëm përmes Udhëzimeve Administrative, por nuk është arrit qëllimi i objektivave. Ndërsa, me opsionin e tretë kemi paraparë hartimin e Ligjit të ri për Bujqësi Organike. Nevoja e hartimit të Ligjit të ri për Bujqësi Organike është e domosdoshme për shkak të dinamikave në këtë sektor, si dhe plotësimin e vakumeve në hartimin e ligjit.

3.1: Opsioni i parë asnjë ndryshim

Opsioni i parë është që të vazhdohet me zbatimin e politikës dhe kornizës ligjore aktuale për Bujqësi Organike. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural do të vazhdonte me zbatimin e Ligjit aktual për Bujqësi Organike. Por, zbatimi i këtij ligji në praktikë është sfidues për MBPZHR-në, IBK-në dhe AUV-in, andaj me vazhdimin e opsionit pa ndryshime do të vazhdojnë edhe vështirësitë e paraqitura.

Sa i takon barrës administrative, ky opsion nuk parasheh masa, andaj ndikimi në barrën administrative është i paverejtshëm.

3.2. Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit të ligjit

Ky opsion parasheh ndryshimin dhe plotësim të Ligjit për bujqësi organike, i cili do të eliminonte shkaqet dhe efektet e cekura të definimit të problemit.

Departamenti për Politika Bujqësore dhe Tregje - Divizioni i Prodhimtarisë Bimore dhe Ujitjes është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për bujqësi organike përmes inspektorëve fitosanitar. Aktualisht numri i inspektorëve është i kufizuar për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të Bujqësisë organike.

Për përmirësimin e menaxhimit të qëndrueshëm të Bujqësisë organike Opsioni 2 parasheh të ndërmerren këto masa:

- Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e Ligjit.
- Mbrojtja e shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe mjedisit.
- Ngritja e vetëdijes për rëndësinë e bujqësisë organike.
- Rritja e buxhetit për trajnimin e këshilltarë dhe inspektorëve fitosanitar për bujqësi organike.
- Koordinim më i mirë ndërinstitutional në mes MBPZHR, IBK-së, AUV-it, Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë (FBV), Doganës, Kompanive, si dhe Shoqatave Importuese-tregtuese të produkteve organike me qëllim harmonizimin dhe avancimin e politikave për sektorin e bujqësisë organike.
- Thjeshtim i kërkesave për regjistrim dhe raportim për operatorët dhe trupat e kontrollit, përmes digjitalizimit.
- Vetëdijësimin e fermerëve përmes organizimit të kampanjës dhe sensibilizimit të institucioneve përgjegjëse, mbi rolin e sektorit të bujqësisë organike.

3.3. Opsioni i tretë

Ky opsion parasheh hartimin e Projekt Ligjit për Bujqësi Organike, i cili do të eliminojë shkaqet dhe efektet.

Projektligji i ri do të përcaktojë:

- **Harmonizimin e Kornizës ligjore aktuale me atë BE-së Nr. 2018/848, e cila trajton disa çështje siç janë:**
 - Udhëzimet do të jenë më të qarta lidhur me kriteret për mbetjet e paqëllimshme të pesticideve;
Kur trupa e kontrollit merr informacion të vërtetuar për praninë e produkteve ose substancave të palejuara në prodhimin organik mbetjet e paqëllimshme të pesticideve ose është njoftuar nga një operator ose zbulon produkte ose substanca të tilla në një produkt organik ose në kalim, kryet menjëherë një hetim zyrtar për të përcaktuar burimin dhe shkakun e pranisë së tyre, brenda një periudhe të caktuar duke marrë parasysh jetëgjatësinë e produktit dhe kompleksitetin e rastit;

Produkti në fjalë nuk tregtohet si produkt organik ose në kalim dhe nuk përdoret në prodhimin organik, nëse trupa e kontrollit ose autoriteti kompetent përkatës i kontrollit zyrtar që kryen hetimin zyrtar ka përcaktuar se operatori:

- Ka përdorur produkte ose substanca të palejuara për t'u përdorur në prodhimin organik;
- Nuk ka marrë masat paraprake të përcaktuara;
- Nuk ka marrë masa në zbatim të kërkesave të mëparshme përkatëse nga trupa e kontrollit ose autoriteti kompetent përkatës i kontrollit zyrtar.

Operatori në fjalë merr masat korrigjuese të nevojshme për të shmangur ndotjet në të ardhmen.

➤ Siguron një kornizë më të qartë për përfshirjen e produkteve shtesë në të ardhmen:

Certifikimi i grupit të operatorëve është një dispozitë e re edhe për BE-në e cila është përafruar në këtë ligj, që i jep mundësi fermerëve të vegjël të certifikohen si grup, duke ulur kostot e certifikimit individual. Rregullat lidhur me përbërjen dhe funksionimin e grupit të operatorëve parashikohen të miratohen me udhëzim të ministrit.

➤ Përfshinë Marrëveshjen e Gjelbër të BE-së dhe Strategjitë Farm to Fork (nga Ferma në Pirun) për Biodiversitetin, e cila synon të përshpejtojë kalimin tonë drejt një sistemi të qëndrueshëm ushqimor që duhet:

- Kenë ndikim neutral ose pozitiv mjedisor;
- Ndihmojnë në zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe përshtatjen ndaj ndikimeve të tij kthimi i humbjes së biodiversitetit;
- Të garantojë sigurinë ushqimore, ushqimin dhe shëndetin publik, duke u siguruar që të gjithë të kenë qasje në ushqim të mjaftueshëm, të sigurt, ushqyes dhe të qëndrueshëm;
- Të ruajë përballueshmërinë e ushqimit duke gjeneruar kthime më të drejta ekonomike, duke nxitur konkurrencën e sektorit të furnizimit të BE-së dhe duke promovuar tregtinë e drejtë.
- Përmirëson transparencën dhe gjurmshmërinë e produkteve organike në të gjithë zinxhirin e furnizimit, si dhe thjeshton sistemin e importit duke u kërkuar vendeve jo anëtare të BE-së që të pajtohen me standardet organike të BE-së.
- **Harmonizimin me standardet e BE-së dhe ato të Federatës Ndërkombëtare për Zhvillim të Bujqësisë Organike (IFOAM).**

Në bazë të rregullores së lëvizjes ndërkombëtare të bujqësisë organike (IFOAM – International Federation of Organic Agriculture Movements) kushtet e prodhimit duhet ti përshtaten

kushteve specifike të secilit vend në të cilën zhvillohet prodhimtaria dhe duhet të jetë e rregulluar me Ligj. Në mënyrë precize janë të definuar kushtet që duhet plotësuar në prodhimtarinë organike. Ngastrat e tokës, fermat blegtorale dhe kapacitetet përpunuese duhet të jenë të izoluar nga burimet e mundshme të ndotjes, uji i cili përdoret për ujtime duhet të jetë i kualitetit të mirë. Ekspertët dhe prodhuesit duhet të aftësohen dhe të kenë trajnime të vazhdueshme të njohurive. Rregullimin e emërtimeve që përdoren në etiketimin, materialin reklamues ose dokumentet tregtare për produktet organike. Ligji parashikon ndalimin e përdorimit në etiketim, reklamim, ose në dokumentet tregtare, i termave që i referohen prodhimit organik të një produkti i cili nuk është në përputhje me kërkesat e ligjit. Gjithashtu, termat që i referohen prodhimit organik nuk mund të përdoren si markë tregtare, emra të kompanisë, njësive të shitjes, ose praktika të tjera të përdorura në etiketim ose reklamim, që mund të keq informojnë ose mashtrorin konsumatorin ose përdoruesin duke sugjeruar se një produkt ose përbërësit e tij plotësojnë kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.

- **Listën zyrtare për Inpute Organike**

Përfshirjen e produkteve dhe substancave organike që lejohen të përdoren në prodhimtarinë organike. Lista e Inputeve Organike përcakton produktet dhe substancat që lejohen për t'u përdorur në bujqësinë organike në përputhje me Ligjin.

Lidhur me produktet dhe substancat që përdoren në prodhimin organik, përveç listës së produkteve dhe substancave për përdorim në prodhimin organik (lëndë vepruese në përbërje të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve "PMB" dhe Produkteve Plehëruese "PP") plotësisht e harmonizuar me listën e BE-së, që miratohet me vendim të Ministrit, do të miratohet edhe lista pozitive e PMB-ve dhe PP-ve që përdoren në prodhimin organik, sipas procedurave të legjislacionit përkatës për inputet organike, nga komisionet respektive në Ministri.

- **Rregullimin e çështjes së emërtimeve që përdoren në etiketimin, materialin reklamues ose dokumentet tregtare për produktet organike.**

Parashikon rregullat për përdorimin e termave që i referohen prodhimit organik (termi "organik" ose "biologjik" dhe shkurtime, si "bio" ose "eko") në etiketimin, reklamimin ose dokumentet tregtare të produktit organik që plotëson kërkesat e ligjit. Ligji parashikon ndalimin e përdorimit në etiketim, reklamim, ose në dokumentet tregtare, i termave që i referohen

prodhimit organik të një produkti i cili nuk është në përputhje me kërkesat e ligjit. Gjithashtu, termat që i referohen prodhimit organik nuk mund të përdoren si markë tregtare, emra të kompanisë, njësive të shitjes, ose praktika të tjera të përdorura në etiketim ose reklamim, që mund të keq informojnë ose mashtrojnë konsumatorin ose përdoruesin duke sugjeruar se një produkt ose përbërësit e tij plotësojnë kërkesat e përcaktuara në këtë ligj. Janë përcaktuar rregullat për etiketimin e produkteve në kalim dhe ushqimeve organike të përpunuara. Përcakton treguesit e detyrueshëm që duhet të vendosen në etiketimin e produkteve organike. Përcaktohet kur përdoret logoja kombëtare e prodhimit organik, në etiketimin, paraqitjen dhe reklamimin e produkteve të prodhuara në vend, të cilat plotësojnë kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe që vendosen në tregun e Kosovës. Logo evropiane për prodhimin organik mund të përdoret në etiketimin, paraqitjen dhe reklamimin e produkteve të importuara në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligj.

- **Rregullimin e disa specifikave gjatë procesit të konvertimit nga bujqësia konvencionale në bujqësi organike të qëndrueshme me efekte mjedisore dhe reduktimin e ndryshimeve klimatike.**

Rregullimi i specifikave gjatë konvertimit do të kontribuojë për mbrojtjen e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike. Do të ruaj pjellorinë afatgjatë të tokës dhe të kontribuojë për një nivel të lartë të biodiversitetit. Do të kontribuojë për standardet e larta për mirëqenien e kafshëve dhe të nxisë ruajtjen e racave të rralla dhe autoktone në rrezik zhdukje, do të nxitë shkurtimin e zinxhirit nga prodhimi deri te shpërndarja në zona të ndryshme lokale të vendit për prodhimin e produkteve ushqimore me cilësi të lartë.

- **Rregullimin e kritereve të produkteve që janë të prodhuara përmes Organizmave të Modifikuar Gjenetikisht (OMGJ).**

Sa i përket Organizmave të Modifikuar Gjenetikisht (OMGJ), duhet theksuar se në Kosovë nuk është i lejuar përdorimi i tyre apo produktet e prodhuara prej tyre, të cilat do të mund të përdorehin si ushqim për njerëz dhe kafshë, ose produkte ndihmëse për përpunimin, produkte për mbrojtjen e bimëve, plehërues, kondicionerë të tokës, materiale riprodhuese bimore, mikroorganizma ose kafshë në prodhimin organik. Andaj, mos identifikimi i OMGJ-ve krijon pasiguri rreth cilësisë së produkteve në përgjithësi, veçanërisht tek produktet organike të cilat

duhet të jenë të sigurta për konsumatorët që nuk dëshirojnë të konsumojnë produkte të prodhuara përmes OMGJ-ve. Në Rregulloren (KE) 2018/848 janë të specifikuara kriteret e produkteve që janë të prodhuara përmes OMGJ.

- **Rregulloret për prodhimin e produkteve të ndryshme nga farërat dhe materiali riprodhues vegjetative.**

Prodhueseve të sektorit të Bujqësisë Organike të cilët produktet e tyre i përfitojnë nga farërat dhe materiali riprodhues vegjetative, ndryshimi dhe fuqizimi i rregulloreve adekuate të Bujqësisë Organike ju siguron se materiali riprodhues bimor posedon diversitetin e lartë gjenetik dhe fenotipik dhe duhet të jetë i disponueshëm për përdorim në prodhimin organik. Përdorimi i farave me një shkallë të lartë diversitetin gjenetik, rezistencë ndaj sëmundjeve dhe jetëgjatësisë siguron certifikim më të lehtë.

- **Kriteret lidhur me përbërjen e ushqimit organik të përpunuar.**

Në mungesë të kriterëve lidhur me ushqimin organik të përpunuar, operatorët që prodhojnë ushqim organik ose ushqim për kafshë duhet t'i ndjekin procedurat e duhura bazuar në identifikimin sistematik të hapave kritikë të përpunimit, në mënyrë që të sigurohet që produktet e përpunuara të jenë në përputhje me rregullat e prodhimit organik. Produktet organike të përpunuara duhet të prodhohen duke përdorur metoda të përpunimit të cilat garantojnë ruajtjen e karakteristikave dhe cilësive organike të produkteve në të gjitha fazat e prodhimit organik.

- **Rregullat shtesë për delegimin e detyrave të kontrollit zyrtar dhe detyrave që lidhen me veprimtari të tjera zyrtare, dhe kontrollit zyrtar në lidhje me përdorimin e Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve Organike.**

Autoritetet kompetente kanë procedura dhe marrëveshje për të siguruar mbikëqyrjen e organeve të kontrollit, duke përfshirë verifikimin që detyrat e deleguara janë kryer në mënyrë efektive, të pavarur dhe objektive, veçanërisht për sa i përket intensitetit dhe shpeshtësisë së verifikimit të përputhshmërisë. Procedura e vlerësimit të rrezikut, e cila do të përcaktojë, në veçanti, bazën për intensitetin dhe shpeshtësinë e verifikimit të përputhshmërisë së operatorëve dhe grupeve të operatorëve.

- **Përfaqësimin efikas të interesave të fermerëve dhe shoqatave të fermerëve të biznesit për regjistrimin e ri dhe zhvillimin e bujqësisë organike.**

Zhvillimi i bujqësisë organike, mund të nxitë interesimin e fermerëve, dhe shoqatave të fermerëve për biznese të reja për të prodhuar produkte cilësore, të cilët mund të regjistrohen si operatorë (kompani prodhues, eksportuese dhe tregtuese) për produktet organike, andaj në bazë të kërkesave të tregut për produkte organike duhet të rritet numri i bizneseve në këtë sektor.

- **Rregullat për importin dhe eksportin e produkteve organike dhe atyre ne konvertim.**

Është shumë e nevojshme për t'ju përgjigjur pritshmërisë së konsumatorëve që produktet organike të importuara plotësojnë standarde të larta dhe për të siguruar më mirë aksesin e produkteve organike të vendit në tregun ndërkombëtar. Përveç kësaj, është e nevojshme të sigurohet qartësi në lidhje me rregullat e zbatueshme për eksportin e produkteve organike, veçanërisht duke vendosur certifikata të eksportit organik. Kjo vlen edhe për Importin dhe eksportin e prodhimeve organike ne konvertim.

Mungesa e disa specifikave gjatë procesit të konvertimit e vështirëson sigurinë e vlerësimit të tokave ku kultivohen produktet organike të cilat nuk duhet të ketë mbetje kimike nëse eventualisht janë përdorur në të kaluarën. Prandaj, pas një periudhe të përshtatshme konvertimi, njësitë bujqësore në vend që synojnë të bëhen organike duhet të menaxhohen tërësisht në përputhje me kërkesat e zbatueshme për prodhimin organik.

- **Rregullat dhe qartësinë e certifikimit grupor për standardin organik.**

Certifikimi i grupit të operatorëve është një dispozitë e re edhe për BE-në e cila është përafruar në këtë ligj, që i jep mundësi fermerëve të vegjël të certifikohen si grup, duke ulur kostot e certifikimit individual. Rregullat lidhur me përbërjen dhe funksionimin e grupit të operatorëve parashikohen të miratohen me udhëzim të ministrit. Certifikimi i grupit të operatorëve është një dispozitë e re edhe për BE-në e cila është përafruar në këtë ligj, që i jep mundësi fermerëve të vegjël të certifikohen si grup, duke ulur kostot e certifikimit individual. Rregullat lidhur me përbërjen dhe funksionimin e grupit të operatorëve parashikohen të miratohen me akt nënligjor nga Ministria.

- **Kriteret për certifikimin e verërave organike.**

Megjithatë, duke qenë se vera është një kategori specifike dhe e rëndësishme e produkteve organike, rregullat shtesë të detajuara të prodhimit duhet të përcaktohen posaçërisht për “verën organike”. Vera organike duhet të prodhohet tërësisht nga lënda e parë organike dhe duhet të lejohen të shtohen vetëm disa produkte dhe substanca të autorizuar në përputhje me këtë rregullore. Përdorimi i disa praktikave, proceseve dhe trajtimeve enologjike në prodhimin e verës organike duhet të ndalohet. Praktikrat, proceset dhe trajtimet e tjera duhet të lejohen në kushte të përcaktuara mirë sipas Rregullores (BE) 2018/848, e cila në të ardhmen do të jetë e zbatueshme edhe në vendin tonë.

- **Transpozimi i rregullave dhe direktivave të Acquis të BE-së për produktet për bujqësi organike.**

Synimi i përgjithshëm i këtij koncept dokumenti është që të krijohet korniza ligjore e cila mundëson: (i) Importin e inputeve cilësore, të cilat janë të domosdoshme për mbrojtjen e fermerëve prodhues; (ii); Ndikim në zhvillimin e sektorit të prodhimtarisë bimë cilësore; (iii) Rritjen e rendimenteve mesatare organike në nivel vendi; (iv) Përfitimi i produkteve kualitative të cilat do të kenë ndikim në shëndetin publik. Objektivat specifike të përcaktuara me këtë koncept dokument janë: (i) Transpozimi i legjislacionit të BE-së (‘Acquis’) nga sektori i Bujqësisë Organike në legjislacionin vendor; (ii) Përmirësimi i kontrollit sipas standardeve ndërkombëtare (Rregullores së re të BE-së 2018/848); (iii) Përcaktimi i institucionit përgjegjës për certifikim të produkteve organike, realizimin e testimeve duke zbatuar standardet ndërkombëtare; (iv) Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e Ligjit dhe inspektimin e inputeve pas regjistrimit të tyre në Listën Nacionale të Inputeve Organike, dhe Listën FIBL (Lista e Inputeve Organike/Instituti Zviceran i Hulumtimeve për Kontroll Biologjike); (v) mbrojtja e fermerëve vendor nga importimi dhe tregtimi i produkteve jo cilësore dhe ngritja e vetëdijes për rolin dhe rëndësinë e Bujqësisë Organike.

- **Rregullimin e kriterëve lidhur me masat ndaj personave fizik apo juridik të cilët veprojnë në kundërshtim me Ligjin për bujqësi organike sipas Rregullores së BE-së 2016/429.**

Regjistrimi i personave fizikë dhe juridikë që angazhohen zyrtarisht në tregtinë e produkteve organike dhe vënia para drejtësisë e atyre që merren me aktivitete të paligjshme, do të ulë sasinë

e produkteve organike jo cilësore dhe të dyshimta në treg. Për këtë arsye, kontrole më të rrepta mbi tregun e produkteve organike duhet të zbatohen nga Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinës në bashkëpunim me Institutin Bujqësor të Kosovës të cilat funksionojnë në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

- **Harmonizohet me kërkesat e LPPA, sidomos sa i përket parimeve si ai vetëm një herë, parimi i mos-pagesës, apo ofrimi i shërbimeve me kohë.**

Në kuadër të këtij optionsi, do të ndërmerreshin edhe masa për ngritjen e kapaciteteve vendore për të ulur kostot për operatorët. Për më tepër, me qëllim të lehtësimit të kërkesave për ofrim të informacionit, do të ndërmerren masa për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e zgjidhjeve të teknologjisë informative. Për më tepër do të ndërmerren hapa për zhvillimin e treguesve kyç të suksesit për të matur rezultatet në zvogëlim të barrës administrative, përmes përdorimit të Modelit të Kostos Standarde.

Përveç masave si më lartë, do të vazhdohet me programet mbështetëse për fermerët, në procesin e certifikimit dhe konvertimit në mënyrën organike të prodhimit.

Në anën tjetër, si rezultat i përafrimit me legjislacionin e përmendur të BE, Ministria do të zhvillojë Listën Kombëtare të Inputeve Organike, gjë që do të mund të shtojë barrën administrative për fermerët. Megjithatë, Ministria do të ketë parasysh masat e përmendura, për zvogëlim të barrës administrative, gjatë zhvillimit të kësaj liste.

Praktikat e vendeve të rajonit, të cilat mund të gjejnë zbatim në Republikën e Kosovës dhe të cilat do të merren parasysh gjatë hartimit të Projektligjit janë:

Republika e Kosovës dhe vendet e Ballkanit Perëndimor janë të obliguara të transformojnë/zbatojnë **Rregulloren e BE-së Nr. 2018 / 848** për Prodhimin Organik dhe Etiketimin e Produkteve Organike në legjislacionin e tyre kombëtar.

Legjislacioni ekzistues Nr. 04/L-085 për Bujqësi Organike, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, nuk sigurojnë funksionimin e duhur të sistemit të kontrollit dhe tregut të produkteve organike me qëllim sigurimin e besimit të konsumatorit për produktet e etiketuara si organike, prandaj ishte i nevojshëm përditësimi me kërkesat e legjislacionit të ri evropian.

Për përmirësimin e sektorit të bujqësisë organike dhe mangësitë e Ligjit aktuale Nr. 04/L-085 për Bujqësi Organike është paraparë hartimi i Ligjit të ri për Bujqësi Organike, i cili do të jetë në përputhje me Rregulloren (BE) Nr. 2018/848, e cila do t'i eliminonte shkaqet dhe efektet të definimit të problemit. Përmes ligjit të ri për bujqësi organike do të krijohet korniza rregullative gjithëpërfshirës në përputhje me standardet ndërkombëtare, siç parashikohet nga Rregullorja (BE) Nr. 2018/848 dhe do të ketë ndikimin në zhvillimit të bujqësisë organike dhe vlerën e prodhimit dhe konkurrencës.

Në Rregulloren (BE) Nr. 2018/848 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 30 maj 2018 për Prodhimin Organik dhe Etiketimin e Produkteve Organike dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (BE) Nr. 834/2007, ka adresuar dhe përmirësuar disa problematika të hasura gjatë zbatimit të ligjit ekzistues, si më poshtë:

- Lidhur me produktet dhe substancat që përdoren në prodhimin organik, përveç listës së produkteve dhe substancave për përdorim në prodhimin organik (materia aktive në përbërje të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve “PMB” dhe Produkteve Plehëruese “PP”) plotësisht e harmonizuar me listën e BE-së, do të miratohet edhe lista pozitive e PMB-ve dhe PP-ve që përdoren në prodhimin organik, sipas procedurave të legjislacionit për produktet e mbrojtjes së bimëve dhe të produkteve plehëruese, nga komisionet respektive në Ministri.
- Procedura për regjistrimin e aktivitetit të operatorëve organikë është adresuar tek autoritetet kompetente përkatëse të kontrollit zyrtar, të cilat krijojnë dhe mirëmbajnë data baza për të gjithë operatorët nën sistemin e certifikimit organik, duke përfshirë edhe importuesit dhe eksportuesit duke mundësuar gjenerimin e një informacioni më të gjerë për operatorët organikë.
- Përrjashtimet nga rregullat e prodhimit organik do të miratohen nga Komisioni për Bujqësi Organike (“KBO”), që funksionon në Ministri, ndërsa miratoheshin nga Trupat e Kontrollit (“TK”).
- Kriteret dhe procedura për miratimin e TK (janë shtuar dispozita dhe kërkesa për njoftimin e aktivitetit nga TK të cilat certifikojnë sipas standardeve organike të tjera nga ky ligj, me qëllim vendosjen e komunikimit dhe marrjen e informacionit nga këto TK).
- Parashikohen masa specifike që duhen marrë nga operatorët dhe grupet e operatorëve në rast mospërputhje me rregullat e prodhimit organik.

- Përcakton sistemin e kontrollit zyrtar për prodhimin organik nga TK dhe autoritetet kompetente përkatëse të kontrollit zyrtar të cilat do të plotësohen nga parashikimet në projektligjin për kontrollet zyrtare.
- Janë përcaktuar në ligj detyrimi për autoritetet doganore për të paraqitur në bazë vjetore të dhëna për import-eksportin e produkteve organike në Ministri.
- Unifikimi i katalogut të masave, i cili do të hartohet nga Ministria, ndërsa më parë bëhej nga TK.
- Rregullon regjimin e importit ekuivalent me atë të BE-së, duke përcaktuar kushtet dhe masat për importin e produkteve organike, nga vendet e BE-së dhe vendet e treta.
- Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet ndaj operatorëve organikë dhe trupave të kontrollit janë përcaktuar për herë të parë, me qëllim mbrojtjen nga përdorimi fiktiv/mashtues i termave që i referohen metodës së prodhimit organik, në etiketim apo reklamim, si dhe për të ndëshkuar përsëritjen e shkeljeve të dispozitave të këtij ligji.

Ligji i ri për Bujqësi Organike do të jetë në harmoni me Rregulloren e BE-së 2018/848, do të ketë një funksionim më efikas të sistemit të kontrollit dhe tregut të produkteve organike, rritje të numrit të operatorëve të prodhimit organik, komunikim dhe shkëmbim të informacionit midis autoriteteve kompetente të kontrollit zyrtar dhe trupave të kontrollit, duke siguruar besimin te konsumatori për produktet e etiketuara ose reklamuar si organike.

Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme
Ndikimet më të rëndësishme të identifikuara për kategorinë e ndikimit

Kategoritë e ndikimeve	Ndikimet përkatëse të identifikuara
Ndikimet ekonomike	Rritet numri i vendeve të punës; Efekt në nivel të pagesës; Ndikim në qasjen në financa për biznes; Largohen nga tregu produkte të caktuara (jo cilësore); Lejohen në treg produkte të caktuara (cilësore); Do të krijohen biznese të reja.
Ngarkesa administrative	Përmbushja e detyrimeve e reja të informacionit nga bizneset; Thjeshtësim i detyrimeve për dhënien e informatave për bizneset.
Tregtia	Ndryshim në flukset aktuale të importit; Ndryshim në flukset aktuale të eksportit;
Investimet	Pritje nga kompanitë të investojnë në veprimtari të reja; Rritje e investimeve nga diaspora; Rritje e investimeve të huaja direkte;
Konkurrueshmëria	Promovim i inovacionit dhe hulumtimit;
Ndikimi në NVM	Kompanitë prekin kryesisht Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
Ndikimet ekonomike rajonale	Ndikim në sektorë të veçantë të biznesit;
Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik	Ndikim në rritjen ekonomike
Ndikimet sociale	Rritet numri i vendeve të punës; Efekt në nivelin e pagesës; Ndikim në uljen e varfërisë; Ndikim në arsimimin e punëtorëve dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës.
Qeverisja	Trajtimi në mënyrë të barabartë; Informim më mirë i publikut;
Shëndeti dhe siguria publike ¹	Ndikimi në jetën e njerëzve; Ndikimi në cilësinë e ushqimit; Ulet rreziku për shëndetin.
Ndikimet mjedisore Mirëqenia e kafshëve	Ruajtja e biodiversitetit; Ndikim në shëndetin e kafshëve; Ndikim në cilësinë dhe sigurinë e ushqimit të kafshëve.

¹ Kur ka ndikim në shëndet publik dhe siguri, atëherë rregullisht ka ndikime mjedisore.

të kenë ndikim në largimin e produkteve organike me cilësi të dobëta nga tregu dhe mospërdorimi i tyre nga ana e fermerëve prodhues.

Lejimi në treg i produkteve të caktuara

Lejimi i tregtimit të produkteve organike do të jetë sipas kriterëve dhe procedurave standarde të përcaktuar me Ligjin e ri për Bujqësi Organike i cili do të jetë në harmoni me legjislacionin e BE-së.

Krijimi i bizneseve të reja

Zhvillimi i bujqësisë organike, mund të nxitë interesimin e bizneseve të reja për të prodhuar produkte cilësore, të cilët mund të regjistrohen si operatorë (kompani prodhues, eksportuese dhe tregtuese) për produktet organike, andaj në bazë të kërkesave të tregut për produkte organike duhet të rritet numri i bizneseve në këtë sektor

Përmbushja e detyrimeve e reja të informacionit nga bizneset

Detyrimet dhe kërkesat mund të përshtaten me rrethanat kombëtare, duke i mundësuar vendit të përshtatë çdo detyrim administrativ me atë që është rreptësisht e nevojshme vetëm sipas një vlerësimi të arsyeshëm të rrezikut.

Thjeshtësim i detyrimeve për dhënien e informatave për bizneset

Dhënia e informatave për bizneset, lidhur me të gjitha procedurat dhe kriteret për konvertim dhe kultivim të produkteve organike në Kosovë, do të jenë më të thjeshtësuara, duke i informuar palët e interesit (bizneset) përmes shpërndarjes së informacioneve në forma të ndryshme elektronike, përfshirë edhe web faqen e MBPZHR-së. Detyrimet për operatorët janë shumë më të qarta dhe kjo në terma afatgjatë lehtëson procedurën e administrimit.

Ndryshueshmëria e flukseve aktuale të importit

Ndryshimi i fluksit të importit aktual të produkteve organike, do të jetë i mundur duke i mbështetur importuesit dhe tregtuesit vendor, të cilët do të mund t'i furnizojnë fermerët me inpute organike cilësore që japin efekt në prodhim dhe cilësi të lartë. Po ashtu, sektori i bujqësisë organike kontribuon në vlerën më të lartë të prodhimit dhe rritjen e konkurrencës, duke rritur kështu mundësitë e reja të punës.

Ndryshueshmëria e flukseve aktuale të eksportit

Momentalisht në Kosovë janë disa operatorë ekonomikë të certifikuar për importimin dhe tregtimin e produkteve organike, megjithatë të njëjtat kompani kanë për synim edhe avancimin e standardeve sa i përket tregtimit, ruajtjes, deponimit dhe shpërndarjes të produkteve organike. Mirëpo duhet theksuar se zhvillimi i sektorëve tjerë është i ndërlidhur ngushtë me investimet në rritjen e kapaciteteve profesionale dhe teknike në kompanitë prodhuese të produkteve organike. Pritet rritje e eksportit pasi që prodhimi aktual eksportohet në shtetet e BE-së.

Pritet që kompanitë të investojnë në aktivitete të reja

Të gjitha kompanitë prodhuese apo përpunuese të produkteve organike pritët të investojnë në brende të reja dhe të ndryshme, të cilat origjinën e tyre të sigurtë do ta kenë nga produktet organike.

Investimet nga diaspora

Me hyrje në fuqi e të Ligjit të ri për bujqësi organike, do të krijohen hapësira për palët që kanë për synim investimet në zhvillimin e sektorit të bujqësisë organike në vendin tonë, të cilat mund të jenë edhe operatorë të jashtëm nga diaspora të cilët do ta kenë mundësinë e investimeve në bujqësi organike. Investimet në sektorin e bujqësisë organike nga diaspora në vendin tonë do të kenë ndikim në ngritjen e standardeve të cilësisë duke u bazuar në praktikat e vendeve të ndryshme të botës nga të cilat vijnë investitorët. Duke ofruar mundësi të reja biznesi, diaspora mund të stimulohet për investime, për shkak të mundësive më të mira tregtare në afat të gjatë dhe kërkesave për produkte organike nga shtetet e BE-së.

Investimet e huaja direkte

Investimet e huaja të mëtutjeshme në sektorin e bujqësisë organike do të jenë të mundshme, sepse aktualisht është e pamundshme furnizimi i tregut tonë me produkte të ndryshme organike, andaj kjo gjendje mund të nxitë kompanitë e huaja importuese dhe tregtuese të produkteve organike të realizojnë investime direkte në vendin tonë. Duke ofruar mundësi të reja biznesi, investimet e huaja direkte mund të tërhiqen për shkak të mundësive më të mira tregtare në afat të gjatë, por edhe të kërkesave të disa produkteve specifike organike në tregun e BE-së.

Promovimi i inovacionit dhe hulumtimi

Ky sektor është në zhvillim e sipër, dhe gjithsesi ka hapësira për inovacione dhe punë kërkimore, andaj novacionet përmes hulumtimeve për cilësi më të lartë për produkte të ndryshme organike do të realizohet përmes analizave laboratorike, si dhe do të krijohen mundësi për promovimin e cilësive të tyre përmes vetëdijesimit të konsumatorëve.

Ndikimi në NMV

Shumica e kompanive në tregun kombëtar janë Ndërmarrje të Mesme edhe të Vogla (NMV), andaj përmirësimi i rregullativës ligjore për bujqësi organike do të krijojë mundësi për zhvillimin e suksesshëm të sektorit të bujqësisë organike, duke i krijuar hapësirë bizneseve që importojnë dhe tregtojnë produkte organike të cilët do të ndikojnë në zhvillimin e suksesshëm të bizneseve në sektorin e bujqësisë organike.

Ndikim në sektorë të veçantë të biznesit

Zhvillimi i sektorit të bujqësisë organike, do të ketë ndikim në furnizimin e tregut me produkte organike të cilat do të jenë më të sigurta dhe gjithsesi më të shëndetshme në gjithë zinxhirin ushqyes të njerëzve por edhe kafshëve.

Ndikim në rritjen ekonomike

Bujqësia Organike gjithsesi do të ketë ndikim në zhvillimin ekonomik në nivel vendi duke pasur efekt në ndikimin e rritjes së prodhimit të bimave në vendin tonë, me theks të veçantë prodhimit të organikëve. Përcaktuar nga produktiviteti më i lartë dhe potenciali i rritjes së prodhimit bimor në nivel vendi do të jap kontribut të pritshëm duke e forcuar rritjen ekonomike, si dhe duke kontribuar në uljen e mundshme të inflacionit.

NDIKIMET SHOQËRORE

Rritet numri i vendeve të punës

Përmirësimi i gjendjes në sektorin e bujqësisë organike kontribuon në përmirësimin e prodhimit bimor lokal si dhe në zbutjen e varfërisë në zonat rurale nëpërmjet vlerës më të lartë të prodhimit dhe mundësive të reja të punësimit. Prandaj, niveli i punësimit mund të rritet me ndikim më të fortë në afat të gjatë.

Efekt në nivelin e pagesës

Stafi profesional dhe i trajnuar të cilët do të japin kontribut në zhvillimin e sektorit të bujqësisë organike, do t'ju krijohen kushte më të mira në aspekti financiar, duke u trajtuar veçantë përmes pagave më të larta.

Ndikim në uljen e varfërisë

Përmirësimi i gjendjes në sektorin e bujqësisë organike kontribuon në përmirësimin e prodhimit bimor vendor si dhe në zbutjen e varfërisë në zonat rurale nëpërmjet vlerës më të lartë të prodhimit dhe mundësive të reja të punësimit.

Ndikimi në arsimim

Zhvillimi dhe arsimimi i stafit profesional dhe teknik do të mund të plotësohet përmes ndjekjes së trajnimeve të organizuara nga institucione përkatëse me qëllim përgatitjen e kuadrove profesionale, të cilat do të japin kontributin e tyre në zhvillimin e sektorit të bujqësisë organike në të ardhmen.

Efekt në arsimimin e punëtorëve dhe mësimin e përgjithshëm

Fermerëve do t'ju duhet që t'i përditësojnë njohurit e reja në bujqësi organike, prandaj fermerët prodhues duhet të ndjekin trajnime të vazhdueshme gjatë gjithë kohës për të qenë të informuar me zhvillimet e trendëve global të sektorit të bujqësisë organike.

Trajtimi në mënyrë të barabartë

Personat fizik apo juridik të cilët do të merren me bujqësi organike, do të jenë të barabartë pa dallime gjinore, përkatësie etnike apo religjioni, duke i respektuar rregullat që do të përcaktohen në Ligjin e Bujqësisë organike.

Informimi më i mirë i publikut

Sipas Parimit të transparencës, kërkohet që të dhëna të caktuara të jenë të disponueshme për publikun, andaj të gjitha palët e interesuara (publiku), do të jenë të informuar me rregullat apo kriteret të cilat do të paraqiten në Ligjin e ri për Bujqësi organike, i cili do të jetë i publikuar në web-faqen e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Ndikimi në jetën e njerëzve

Me vendosjen e këtyre politikave apo me hartimin e Ligjit të ri të Bujqësisë organike do të synohet përmirësimi i tregut me produkteve organike cilësore, të cilat pa dyshim do të kenë efekt në ruajtjen e shëndetit të njeriut, kafshëve dhe bimëve. Furnizimi i konsumatorëve me produkte organike dhe me vlera cilësore ndikon në zinxhirin ushqimorë, pra produkte bimore që padyshim kanë ndikim në ushqyerjen e shëndetshme të popullatës dhe ndikim të jetëgjatësisë dhe në mjedis.

Ndikimi në cilësinë e ushqimit

Nga produktet e fituara do të ketë ndikim në sigurimin e ushqimit primarë për popullatën, dhe sigurinë e cila do të ndikoj në shëndetin e përgjithshëm publik që nënkupton se është interes kombëtar në vendin tonë.

Ulet rreziku për shëndetin

Zhvillimi i sektorit të prodhimit të organike redukton rrezikun e njerëzve, kafshëve dhe mjedisit nga substancat e dëmshme kimike të cilat janë të ndaluara për përdorim.

NDIKIMET MJEDISORE

Ruajtja e biodiversitetit

Përmirësimi dhe menaxhimi i sistemit të kontrollit të produkteve organike, nënkupton sigurimin e produkteve të shëndetshme bimore dhe shtazore me vlera të larta ushqyese, të cilat do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e shëndetit të njeriut, kafshëve dhe bimëve. Një nga rregullat e kërkuara nga standardi i bujqësisë organike është që grumbullimi i Produkteve Pyjore Jo Drunore (PPJD-ve) të bëhet në mënyrë të qëndrueshme. Në këtë mënyrë mund të mbrohen llojet e rrezikuara dhe sigurohet ripërtëritja e llojeve të ndryshme të bimëve, frutave dhe kërpudhave në natyrë.

Ndikimi në shëndetin e kafshëve

Zhvillimi i vazhdueshëm i bujqësisë organike do të ketë ndikim në mirëqenien e kafshëve duke e ruajtur ambientin kultivues nga përdorimi i preparateve kimike (pesticidet), të cilat kanë ndikim në ndotjen e tokës dhe ujit, dhe si pasojë mund ta ndryshojnë bilancin e gjallesave që jetojnë në tokë.

Ndikimi në cilësinë dhe sigurinë e ushqimit të kafshëve

Me zhvillimin e bujqësisë organike garantohej cilësia e prodhimeve bujqësore nga të cilat mund të fitohen edhe nënprodukte tjera të shëndetshme vlera të larta ushqyese, të cilat do të kenë ndikim të

drejtpërdrejtë në përmirësimin e shëndetit të kafshëve por edhe të produkteve të prodhuara prej tyre.

TË DREJTAT THEMELORE

Ndikim në mbrojtjen e opsionit për parimin e barazisë para ligjit

Garancitë se dispozitat ligjore do të sigurojnë të drejta të barabarta për të gjitha palët.

Ndikohet mënyra në të cilën administrata merr vendime

Me përmirësimin e kësaj politike, procedurat administrative do të jenë më transparente, do të eliminohen procedurat e tepërta burokratike dhe të përcaktohen afatet procedurale për zgjidhjen e lëndëve sipas LPPA. (Afatet janë të përcaktuara Me Ligjin Për Procedurën e Përgjithshme Administrative)

Të dhënat personale – do të ketë ndikim / ndryshime në të drejtat e individëve dhe të dhënave personale.

Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave

Ndikimi i të dhënave në hartimin e Koncept Dokumentit (mbledhja e të dhënave)

Gjatë hartimit të Koncept Dokumentit për Bujqësi organike jemi shërbyer me të dhëna nga raportimi vjetor i obliguar nga Trupat e Kontrollit që operojnë në Kosovë të cilët raportojnë në MBPZHR. Ndërsa, burime tjera të informacionit janë edhe Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore, Regjistrimi i fundit të Bujqësisë të vitit 2020, 2021 dhe 2022 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe Raportit të Gjelbër 2022.

Meqenëse sigurimi i të dhënave nga fusha e bujqësisë realizohet me vështirësi, veçanërisht si anketa ku përfshihen brenda vitit rreth 4 deri 5 % të numrit të përgjithshëm të ekonomive familjare të Kosovës, ndërsa regjistrimi i bujqësisë realizohet çdo 10 vite, mund të themi se këto të dhëna nuk i plotësojnë kërkesat për analiza më të detajuara dhe të sakta. Të dhënat ekzistuese nuk mund të përfaqësojnë me këtë përqindje të ulët gjendjen reale të ekonomive familjare bujqësore.

Agjencia e Statistikave të Kosovës është gjeneruesi më i autorizuar i të dhënave, ku çdo vit realizon anketën për ekonomi familjare bujqësore me metodën e zgjedhjes së rastit duke përfshirë rreth 4-6% e ekonomive familjare bujqësore ekzistuese. Ndërsa, çdo 10 vite parashihet të organizohet regjistrimi i bujqësisë.

Të dhënat e raportit të Regjistrimit të Bujqësisë për shfrytëzimin e tokës që realizohen çdo 10 vite përfshijnë regjistrimin e të gjitha variablave të shfrytëzimit të tokës së ekonomive familjare, si: sipërfaqet, struktura e kulturave bujqësore, rendimentet, masat agroteknike siç është ujitja dhe trajtimi me plehra e pesticide, etj. Ndërsa, të dhënat e anketave edhe pse realizohen çdo vit, nga përqindja e ulët e përfshirjes së ekonomive bujqësore në anketë nuk mund të themi që janë reprezentative.

Regjistrimi i Bujqësisë që realizohet në bashkëpunim të MBPZHR-së dhe ASK-së, mbetet burimi më i besueshëm i të dhënave të shfrytëzimit të tokës dhe përdorimit të inputeve bujqësore.

Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi

- Procesi i konsultimit synon:
- [Jepni informacionin këtu: Konsultimi paraprak me palët me interes, institucionet akademike, shoqërinë civile dhe organizatat qeveritare dhe jo qeveritare lidhur me nismat e MBPZHR për adresimin e çështjeve të veterinarisë dhe shëndetit publik në përgjithësi përmes legjislacionit dhe opinionet e tyre lidhur me këtë nismë]
- [Kur KD-ja dërgohet për konsultime publike, kolona për buxhet duhet të fshihet]

[Kur KD-ja dërgohet për konsultime publike, titulli i kolonës 'Afati Indikativ' duhet të ndryshohet në 'Afati kohor']

Qëllimi kryesor	Grupi i synuar	Aktiviteti	Komunikimi/njoftimi	Afati indikativ	Buxheti i nevojshëm	Personi përgjegjës
Konsultimi për definimin e problemit	Të gjitha palët e interesuara	Takimi i parë publik	Njoftimi i dërguar përmes postës elektronike zyrtare		Projekti i ZKM	Valdete Avdiu
Konsultimi paraprak ndërministror	Institucionet relevante sipas nenit 7 të Rregullores së punës së Qeverisë	Dërgimi i draft KD	Përmes postës elektronike zyrtare			Valdete Avdiu
Konsultimi publik me shkrim	Institucionet relevante, palët e interesuara	Publikimi i draft KD në portalin e konsultimeve publike	Publikimi në web faqe dhe në llogarinë e facebookut të MBPZHR-së dhe njoftimi për mediat vendore		Pjesa me te verdhe përditësohet krahas zhvillimit të dokumentit	Valdete Avdiu dhe Isah Rudaku
Konsultimi për draftin e parë të KD	Të gjitha palët e interesuara, mbrojtësit e bimëve, institucionet akademike, shoqatat e bujqësisë organike dhe bizneset që tregtojnë me produkte organike, donatorët dhe zyrtarët e komunave	7 Takime të fokusuara në pjesë të ndryshme të vendit, si dhe një takim me donatorët.	Njoftimi i dërguar përmes postës elektronike zyrtare, përmes web faqeve të komunave, rrjetit social facebookut të MBPZHR-së. Njoftimi i mediave lokale për përcjelljen e aktivitetit Për takimin me donatorë të njoftohen të gjitha mediat qendrore		Projekti i ZKM	Valdete Avdiu

Përmbledhje nga aktivitetet publike për Koncept Dokumentin

Organizimi fillestar me palët me interes me dt. **23.04.2024**, ftesat për pjesëmarrje janë dërguar tek këto institucione: MBPZHR, DPBT, AUV, Fakulteti i Bujqësisë, Shoqata ORGANIKA , Kultivuesit e BMA-ve, Grumbulluesit e PPJD, Përpunuesit e BMA-ve dhe PPJD, përfaqësues nga IADK-ja, GIZ-i, SWISSCONATCT si dhe Caritasi.CH, projekti EREA.

Ndërkaq, ftesës për pjesëmarrje i janë përgjigjur këto institucione: MBPZHR, DPBT, AUV, Fakulteti i Bujqësisë, Shoqata ORGANIKA , Kultivuesit e BMA-ve, Grumbulluesit e PPJD, Përpunuesit e BMA-ve dhe PPJD, përfaqësues nga IADK-ja, GIZ-i, SWISSCONATCT, si dhe Caritasi CH., projekti EREA.

Grupi punues ka prezantuar para pjesëmarrësve fillimin e punës së Koncept Dokumentit, i cili ka për qëllim krijimin e një politike për menaxhimin dhe funksionim më efikas të sistemit të kontrollit dhe tregut të produkteve organike, rritje të numrit të operatorëve të prodhimit organik, komunikim dhe shkëmbim të informacionit midis autoriteteve kompetente të kontrollit zyrtar dhe trupave të kontrollit, duke siguruar besimin te konsumatori për produktet e etiketuara ose reklamuar si organike.

Gjatë takimit me palët e interesit u diskutua për mundësinë e përmirësimit të sektorit të bujqësisë organike, si dhe disa nga mangësitë ligjore aktuale:

- Qartësimi i parimeve dhe objektivat bazë për konvertimin, certifikimin dhe prodhimin, përpunimin e produkteve organike;
- Rregullat për regjistrimin e PMB-ve organike;
- Qartësimin e rregullave për importin dhe eksportin e produkteve organike për vendet e treta.
- Rregullat për lëvizjen jo komerciale/fusha eksperimentale në bujqësi organike;
- Dispozitat për kundërvajtje në të gjitha fushat e listuar në Rregulloren e BE-së Nr. 2018/848 etj.

Gjithashtu u rekomandua që të gjitha propozimet e tyre t'i përcjellin përmes e-mail adresave të tyre.

2. Konsultime paraprake ndërministrore nga data: ///

3. Publikimi në platformën online nga data: ///

Njoftimi për këtë në rrjetin social Fcb të MBPZHR-së, e bashkë me këtë edhe hartimi i njoftimit (lajmit) për web faqen e MBPZHR-së dhe media.

Të gjitha publikimet në media që lidhen me temën e Koncept Dokumentit do të bashkëngjiten përmes linçeve në këtë koncept...?

Kapitulli 6: Krahësimi i opsioneve

- Mos ndryshimi i gjendjes aktuale sipas këtij opsioni, do të vazhdoj që objektivat për bujqësi organike të mos arrihen. Për më shumë përgjegjësitë e akterëve të përfshirë në sektorin e bujqësisë organike do të vazhdojnë të mos jenë të qarta lidhur me konvertimin, certifikimin dhe dispozitat e reja ligjore sipas Legjislacionit të bujqësisë organike të BE-së.

- Opsioni i dytë do të kishte përmirësim dhe qartësi të lehtë të dispozitave për bujqësi organike, por pa adresuar opsionet e politikave. Sipas këtij opsioni do të ketë më shumë sqarime të rregulluara me legjislacion dhe përmirësim për palët me interes me të cilin do të kuptonin detyrimet e tyre.
- Opsioni i tretë parashikon Projektligjin e ri në përputhje me standardet ndërkombëtare, të fokusuar në masat parandaluese afatgjate, siç parashikohet nga Rregullorja (BE) Nr. 2018/848. Ky opsion do të ketë ndikim më të qartë në politikat e bujqësisë organike, respektivisht ofron fleksibilitet më të madh dhe barrë administrative më të ulët. Politikat për bujqësi organike do të kontribuojnë në vlerën më të lartë të prodhimit dhe konkurrencës, duke rritur kështu mundësitë e reja që kanë efekte në treg.

Opsioni i propozuar (Opsioni 3) ka ndikime të drejtpërdrejta në reduktimin e ndikimit në shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe ndotjen e mjedisit. Çdo reduktim në shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe ndotjen e mjedisit do të reduktoje rrjedhimisht rreziqet lidhur për shëndetin publik. Pra, ndikimi do të jetë pozitiv, për sa i përket përfitimeve nga arritja e standardeve të qëndrueshme për shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe ndotjen e mjedisit dhe plotësimin e standardeve të qëndrueshme për bujqësi organike.

Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme

Për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Ligji për bujqësi organike dhe adresimin e disa shkaqeve të problemit **Opsioni 2** parasheh:

- Ligji për bujqësi organike i plotësuar dhe ndryshuar;
- Rregullimin e bazës së të dhënave për shëndetin e të kafshëve;
- Shërbimet e ofruara të cilat do të kenë ndikim në parandalimin dhe trajtimin e kafshëve;
- Përcaktimin e kriterëve lidhur me numrin e inspektimeve që do të rekrutohen;
- Planifikimin e numrit të trajnimeve për inspektorë të cilat duhet të jenë së paku tri (3) trajnime;
- Planifikimin e numrit të trajnimeve të stafit në nivelin lokal dhe qendror, të cilat do të jenë së paku pesë (5) trajnime.

PLANI I ZBATIMIT PËR OPSIONIN 2		
Qëllimi i Politikës	Përmirësim dhe qartësi të lehtë të dispozitave për bujqësi organike pa adresuar opsionet e politikave zhvillimore për bujqësisë organike.	Shifra e kostos së pritur
Objekti i Strategjik	Krijimi i mundësive për të adresuar mangësitë sa i përket sektorit të bujqësisë organike	

Objektivi specifik 1: Avancimi i kornizës legjislative dhe rregullative për veterinarinë	Produkti 1.1	Ligji për bujqësi organike i plotësuar							
			2022	2023	2024	2025	2026	Institucioni/Departamenti Përgjegjës	
		Aktiviteti 1.1		X				MBPZHR	
		Hartimi i ligjit							
		Aktiviteti 1.3			X				
	Hartimi i akteve nënligjore								
	Produkti 1.2	Rregullimin e data-bazës për të dhënat e shëndetit të kafshëve							
		Aktiviteti 1.3.1			X			MBPZHR	
		Krijimi dhe përditësimi i të dhënave							
	Produkti 1.3	Shërbimet e ofruara për parandalimin dhe trajtimin e kafshëve;							
		Aktiviteti 1.4.1			X			MBPZHR	
		Masat parandaluese në bujqësinë organike;							
Objektivi specifik 2: Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e Ligjit	Produkti 2.1	Përcaktimi i kritereve për numrin e inspektimeve							
		Aktiviteti 2.1.1		X				MBPZHR/AUV	
		Rekrutimi inspektorëve shtesë për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit							
	Produkti 2.2	Numri i trajnimeve për inspektorët së paku tri (3) trajnime							
		Aktiviteti 2.2.1		X	X	X	X		
		Organizimi dhe mbajtja e trajnimeve							
		Numri i trajnimeve të stafit në nivelin lokal dhe qendror së paku pesë (5) trajnime							

	Produkti 2.3	Aktiviteti 2.3.1						MBPZHR	
		Organizimi i trajnimit të parë dhe të dytë			X				
		Aktiviteti 2.3.2							
		Organizimi i trajnimit të, tretë, katërt dhe të pestë				X			
		Aktiviteti 2.3.3							
		Pjesëmarrja në trajnimet e IKAP për barrë administrative		X	X				
		Aktiviteti 2.3.4							
		Shtimi i stafit që merren me ofrimin e shërbimeve publike				x			
		Aktiviteti 2.3.5							
		Përmirësimi i informimit të palëve rreth shërbimeve (përfshirë në web-faqen e MPBZHR)	X				X		

PLANI I ZBATIMIT PËR OPSIONIN 3

Qëllimi i Politikës	Krijimin e kornizës rregullative gjithëpërfshirës në përputhje me standardet ndërkombëtare, për definimin e qartë të politikave për bujqësi organike të cilat do të ofrojnë fleksibilitet të lartë dhe barrë administrative më të ulët me ndikim në zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë organike							Shifra e kostos së pritur	
Objektivi Strategjik	Avancimi i politikave për siguri ushqimore dhe përafrimi i tyre me standardet e BE-së, të cilat synojnë të sigurojnë një nivel të lartë të ushqimit për njeriun dhe shëndetin e bimëve duke aplikuar bujqësinë organike								
Objektivi specifik 1: - Harmonizimi me Rregulloren e BE-së për Bujqësinë Organike Nr. 2018/848.	Produkti 1.1	Ligji për Bujqësi Organike i hartuar							
		Viti	2025	2026	2027	2028	2029	Institucioni/Departamenti Përgjegjës	
		Aktiviteti 1.1	X						
		Hartimi i Ligjit							
		Aktiviteti 1.2		X					
		Hartimi i Akteve nënligjore							
Produkti 1.2	Mirëmbajtja e sistemeve dhe cikleve natyrore, ruajtjen dhe përmirësimin e pjellorisë së tokës, ujit, bimëve, kafshëve dhe ekuilibrin ndërmjet tyre sipas standardeve të BE-së								
	Aktiviteti 1.2.1 Përgatitja e udhëzimeve më të qarta lidhur me kriteret për mbetjet e pa qëllimshme të pesticideve.		X						
	Aktiviteti 1.2.2 Rregulloret për prodhimin e produkteve të ndryshme nga farërat dhe materiali riprodhuese vegjetative.		X						

	Aktiviteti 1.2.3 Përfshinë Marrëveshjen e Gjellbër të BE-së dhe Strategjitë Farm to Fork (nga Ferma në Pirun) për Biodiversitetin.	X	X	X	X	X		
	Aktiviteti 1.2.4 Përmirëson transparencën dhe gjurmshmërinë e produkteve organike në të gjithë zinxhirin e furnizimit, si dhe thjeshton sistemin e importit duke u kërkuar vendeve jo anëtare të BE-së që të pajtohen me standardet organike të BE-së.	X	X	X	X	X		
	Aktiviteti 1.2.5 Rregullimi i kriterëve lidhur me emërtimet që përdoren në etiketimin, materialin reklamues ose dokumentet tregtare për produktet organike.		X					
Produkti 1.3	Rregullon dhe siguron një kornizë më të qartë për përfshirjen e produkteve dhe substancave organike që lejohen të përdoren në prodhimtarin organike							

		Aktiviteti 1.3.1 Regjistrimi i inputeve të reja në Listën Kombëtare të Imputove Organike duke ju referuar Listës së FIBL-it		X	X	X	X		
		Aktiviteti 1.3.2 Përcaktimin e afatit për hartimin e vendimeve për produktet të cilat do të regjistrohen në Listën Kombëtare të Inputeve Organike.		X	X	X	X		
Objektivi specifik2: Përforcimi i sistemit të kontrollit nga autoritetet përgjegjëse për zbatimin e rregullave për certifikim të produkteve organike, dhe realizimin e testeve laboratorike për mbetjet e Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve tek produktet organike.	Produkti 2.1	Rregullimi i kompetencave institucionale në nivel Kombëtar							
		Aktiviteti 2.1.1 Përcaktimi i kompetencave për autoritetet përgjegjëse për zbatimin e rregullave gjatë procesit të monitorimit, certifikimit dhe realizimit të testeve laboratorike të produkteve organike.	X	X					

	Aktiviteti 2.1.2 Rregullimin e disa specifikave gjatë procesit të konvertimit nga bujqësia konvencionale në bujqësi organike të qëndrueshme me efekte mjedisore dhe luftimin e ndryshimeve klimatike.	X	X	X			
	Aktiviteti 2.1.3 Monitorimi i vazhdueshëm i inputeve organike pas regjistrimit të tyre në Listën Kombëtare të Inputeve Organike.	X	X	X	X	X	
	Aktiviteti 2.1.4 Rregullimin e kriterëve të produkteve që janë të prodhuara përmes Organizmave të Modifikuar Gjenetikisht (OMG).		X	X			
	Aktiviteti 2.1.5 Përcaktimin e kriterëve lidhur me përbërjen e ushqimit organik të përpunuar.		X	X			

		Aktiviteti 2.1.6 Rregullat për importin dhe eksportin e produkteve organike dhe atyre ne konvertim.		X	X				
		Aktiviteti 2.1.7 Rregulloret shitesë për delegimin e detyrave të kontrollit zyrtar dhe detyrave që lidhen me veprimtari të tjera zyrtare.		X	X				
Objektivi specifik 3: Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e Ligjit dhe inspektimi i produkteve organike pas regjistrimit të tyre në Listën Kombëtare të Produkteve Organike.	Produkti 3.1	Rritja e sigurisë përmes inspektorëve fitosanitarë në territorin e Republikës së Kosovës							
		Aktiviteti 3.1.1 Standardizimin e numrit të inspektorëve me numër të sipërfaqeve për monitorimin dhe certifikimin e produkteve organike, sipas praktikave të vendeve të BE-së.	X						
		Aktiviteti 3.1.2 Shtimin e kontrollit në Doganë dhe brenda territorit lidhur me produktet organike të pa certifikuara, të cilat në treg mund të deklarohen dhe	X	X	X	X	X		

		shiten si të certifikuara.						
		Aktiviteti 3.1.3 Rregullimi i gjithë procesit lidhur me certifikimin e verërave organike.		X				
		Aktiviteti 3.1.4 Rregullimin e kriterëve lidhur me certifikimin grupor për standardin organik.	X					
		Aktiviteti 3.1.4 Rregullimin e kriterëve lidhur me masat ndaj personave fizik apo juridik të cilët veprojnë në kundërshtim me Ligjin për Bujqësi Organike.		X				
	Produkti 3.2	Ngritja e kapaciteteve për stafin profesional						
		Aktiviteti 3.2.1 Organizimi i trajnimit të parë dhe të dytë.		X	X			
		Aktiviteti 3.2.2 Organizimi i trajnimit të, tretë, katërt dhe të pestë.			X	X	X	
		Aktiviteti 3.2.3 Organizimi i trajnimit të parë dhe të dytë.		X	X			

		Aktiviteti 3.2.4 Organizimi i trajnimit të tretë, katërt dhe të pestë.			X	X	X		
Objektivi specifik 4: Mbrojtja e fermerëve vendor nga importimi dhe tregtimi i produkteve jo cilësore dhe ngritja e vetëdijes për rolin dhe rëndësinë e produkteve organike.	Produkti 4.1	Kampanja e promovimit të produkteve organike cilësore dhe roli i tyre në prodhimtarinë bimore							
		Aktiviteti 4.1.1 Promovimi i inputeve organike përmes Shërbimeve Këshillimore të organizuar nga niveli qendror dhe lokal, me qëllim shpërndarjen e informacioneve lidhur me rolin dhe rëndësinë e cilësisë së produkteve organike të cilat do të gjinden në regjistrin e Listës Nacionale të Inputeve Organike, si dhe Listën e FIBL-it , dhe po ashtu fermerët do të marrin njohuri lidhur me teknologjitë e reja të kultivimit dhe ndikimin e inputeve organike-cilësore në rritjen e prodhimtarinë	X	X	X	X	X		

		organike në nivel vendi.							
Objektivi specifik 5: Përpjekje të shtuara për zvogëlimin e barrës administrative	Shërbime t publike rreth BO të thjeshtuara dhe digjitalizuara	Aktiviteti 4.1.1 Harmonizimi i legjislacionit me LPPA; 4.1.2 Zhvillimi i zgjidhjes TIK për BO; 4.1.3 Programet e subvencioneve zgjerohen për të për zvogëlim të barrës administrative 4.1.4 Zhvillimi i programeve për zhvillimin e kapaciteteve vendore për certifikim	X		X		X		MBPZHR FBV
			X	X	X	X			

Për përmirësimin e sektorit të bujqësisë organike, Opsioni 3, parasheh hartimin e Ligji të ri për Bujqësi Organike, i cili do të jetë në përputhje me Rregulloren (BE) Nr. 2018/848, i cili do të eliminonte shkaqet dhe efektet të definimit të problemit:

- Ky ligj do të adresonte çështjet që janë të parregulluara apo kanë zbrazëtira juridike. Ligji i ri për Bujqësi Organike do të krijojë kornizë rregullative gjithëpërfshirës në përputhje me standardet ndërkombëtare, dhe do të ketë ndikim e zhvillimit të bujqësisë organike, vlerën e prodhimit dhe konkurrencës.

Projektligji i ri do të përcaktojë:

- **Harmonizimin e Kornizës ligjore aktuale me atë BE-së Nr. 2018/848, e cila trajton disa çështje siç janë:**
 - Udhëzimet do të jenë më të qarta lidhur me kriteret për mbetjet e paqëllimshme të pesticideve;

Kur trupa e kontrollit merr informacion të vërtetuar për praninë e produkteve ose substancave të palejuara në prodhimin organik mbetjet e paqëllimshme të pesticideve ose është njoftuar nga një operator ose zbulon produkte ose substanca të tilla në një produkt organik ose në kalim, kryet menjëherë një hetim zyrtar për të përcaktuar burimin dhe shkakun e pranisë së tyre, brenda një periudhe të caktuar duke marrë parasysh jetëgjatësinë e produktit dhe kompleksitetin e rastit;

Produkti në fjalë nuk tregtohet si produkt organik ose në kalim dhe nuk përdoret në prodhimin organik, nëse trupa e kontrollit ose autoriteti kompetent përkatës i kontrollit zyrtar që kryen hetimin zyrtar ka përcaktuar se operatori:

- Ka përdorur produkte ose substanca të palejuara për t'u përdorur në prodhimin organik;
- Nuk ka marrë masat paraprake të përcaktuara;
- Nuk ka marrë masa në zbatim të kërkesave të mëparshme përkatëse nga trupa e kontrollit ose autoriteti kompetent përkatës i kontrollit zyrtar.

Operatori në fjalë merr masat korrigjuese të nevojshme për të shmangur ndotjet në të ardhmen.

- Siguron një kornizë më të qartë për përfshirjen e produkteve shtesë në të ardhmen;

Certifikimi i grupit të operatorëve është një dispozitë e re edhe për BE-në e cila është përafruar në këtë ligj, që i jep mundësi fermerëve të vegjël të certifikohen si grup, duke ulur kostot e certifikimit individual. Rregullat lidhur me përbërjen dhe funksionimin e grupit të operatorëve parashikohen të miratohen me udhëzim të ministrit.

- Përfshinë Marrëveshjen e Gjellbër të BE-së dhe Strategjitë Farm to Fork (nga Ferma në Pirun) për Biodiversitetin, e cila synon të përshpejtojë kalimin tonë drejt një sistemi të qëndrueshëm ushqimor që duhet:

- Kenë ndikim neutral ose pozitiv mjedisor;
- Ndihmojnë në zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe përshtatjen ndaj ndikimeve të tij kthimi i humbjes së biodiversitetit;
- Të garantojë sigurinë ushqimore, ushqimin dhe shëndetin publik, duke u siguruar që të gjithë të kenë qasje në ushqim të mjaftueshëm, të sigurt, ushqyes dhe të qëndrueshëm;
- Të ruajë përbalueshmërinë e ushqimit duke gjeneruar kthime më të drejta ekonomike, duke nxitur konkurrencën e sektorit të furnizimit të BE-së dhe duke promovuar tregtinë e drejtë.

- Përmirëson transparencën dhe gjurmshmërinë e produkteve organike në të gjithë zinxhirin e furnizimit, si dhe thjeshton sistemin e importit duke u kërkuar vendeve jo anëtare të BE-së që të pajtohen me standardet organike të BE-së.
- **Harmonizimin me standardet e BE-së dhe ato të Federatës Ndërkombëtare për Zhvillim të Bujqësisë Organike (IFOAM).**

Në bazë të rregullores së lëvizjes ndërkombëtare të bujqësisë organike (IFOAM – International Federation of Organic Agriculture Movements) kushtet e prodhimit duhet ti përshtaten kushteve specifike të secilit vend në të cilën zhvillohet prodhimtaria dhe duhet të jetë e rregulluar me Ligj. Në mënyrë precize janë të definuar kushtet që duhet plotësuar në prodhimtarinë organike. Ngastrat e tokës, fermat blegtorale dhe kapacitetet përpunuese duhet të jenë të izoluara nga burimet e mundshme të ndotjes, uji i cili përdoret për ujtime duhet të jetë i kualitetit të mirë. Ekspertët dhe prodhuesit duhet të aftësohen dhe të kenë trajnime të vazhdueshme të njohurive. Rregullimin e emërtimeve që përdoren në etiketimin, materialin reklamues ose dokumentet tregtare për produktet organike. Ligji parashikon ndalimin e përdorimit në etiketim, reklamim, ose në dokumentet tregtare, i termave që i referohen prodhimit organik të një produkti i cili nuk është në përputhje me kërkesat e ligjit. Gjithashtu, termat që i referohen prodhimit organik nuk mund të përdoren si markë tregtare, emra të kompanisë, njësive të shitjes, ose praktika të tjera të përdorura në etiketim ose reklamim, që mund të keq informojnë ose mashtrojnë konsumatorin ose përdoruesin duke sugjeruar se një produkt ose përbërësit e tij plotësojnë kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.

- **Listën zyrtare për Inpute Organike**

Përfshirjen e produkteve dhe substancave organike që lejohen të përdoren në prodhimtarinë organike. Lista e Inputeve Organike përcakton produktet dhe substancat që lejohen për t'u përdorur në bujqësinë organike në përputhje me Ligjin.

Lidhur me produktet dhe substancat që përdoren në prodhimin organik, përveç listës së produkteve dhe substancave për përdorim në prodhimin organik (lëndë vepruese në përbërje të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve “PMB” dhe Produkteve Plehëruese “PP”) plotësisht e harmonizuar me listën e BE-së, që miratohet me vendim të Ministrit, do të miratohet edhe lista pozitive e PMB-ve dhe PP-ve që përdoren në prodhimin organik, sipas procedurave të legjislacionit përkatës për inputet organike, nga komisionet respektive në Ministri.

- **Rregullimin e çështjes së emërtimeve që përdoren në etiketimin, materialin reklamues ose dokumentet tregtare për produktet organike.**

Parashikon rregullat për përdorimin e termave që i referohen prodhimit organik (termi "organik" ose "biologjik" dhe shkurtimet, si "bio" ose "eko") në etiketimin, reklamimin ose dokumentet tregtare të produktit organik që plotëson kërkesat e ligjit. Ligji parashikon ndalimin e përdorimit në etiketim, reklamim, ose në dokumentet tregtare, i termave që i referohen prodhimit organik të një produkti i cili nuk është në përputhje me kërkesat e ligjit. Gjithashtu, termat që i referohen prodhimit organik nuk mund të përdoren si markë tregtare, emra të kompanisë, njësive të shitjes, ose praktika të tjera të përdorura në etiketim ose reklamim, që mund të keq informojnë ose mashtrojnë konsumatorin ose përdoruesin duke sugjeruar se një produkt ose përbërësit e tij plotësojnë kërkesat e përcaktuara në këtë ligj. Janë përcaktuar rregullat për etiketimin e produkteve në kalim dhe ushqimeve organike të përpunuara. Përcakton treguesit e detyrueshëm që duhet të vendosen në etiketimin e produkteve organike. Përcaktohet kur përdoret logoja kombëtare e prodhimit organik, në etiketimin, paraqitjen dhe reklamimin e produkteve të prodhuara në vend, të cilat plotësojnë kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe që vendosen në tregun e Kosovës. Logo evropiane për prodhimin organik mund të përdoret në etiketimin, paraqitjen dhe reklamimin e produkteve të importuara në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligj.

- **Rregullimin e disa specifikave gjatë procesit të konvertimit nga bujqësia konvencionale në bujqësi organike të qëndrueshme me efekte mjedisore dhe reduktimin e ndryshimeve klimatike.**

Rregullimi i specifikave gjatë konvertimit do të kontribuojë për mbrojtjen e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike. Do të ruaj pjellorinë afatgjatë të tokës dhe të kontribuojë për një nivel të lartë të biodiversitetit. Do të kontribuojë për standardet e larta për mirëqenien e kafshëve dhe të nxisë ruajtjen e racave të rralla dhe autoktone në rrezik zhdukje, do të nxitë shkurtimin e zinxhirit nga prodhimi deri te shpërndarja në zona të ndryshme lokale të vendit për prodhimin e produkteve ushqimore me cilësi të lartë.

- **Rregullimin e kriterëve të produkteve që janë të prodhuara përmes Organizmave të Modifikuar Gjenetikisht (OMGJ).**

Sa i përket Organizmave të Modifikuar Gjenetikisht (OMGJ), duhet theksuar se në Kosovë nuk është i lejuar përdorimi i tyre apo produktet e prodhuara prej tyre, të cilat do të mund të përdoren si ushqim për njerëz dhe kafshë, ose produkte ndihmëse për përpunimin, produkte për mbrojtjen e bimëve, plehërues, kondicionerë të tokës, materiale riprodhuese bimore, mikroorganizma ose kafshë në prodhimin organik. Andaj, mos identifikimi i OMGJ-ve krijon pasiguri rreth cilësisë së produkteve në përgjithësi, veçanërisht tek produktet organike të cilat duhet të jenë të sigurta për konsumatorët që nuk dëshirojnë të konsumojnë produkte të prodhuara përmes OMGJ-ve. Në Rregulloren (KE) 2018/848 janë të specifikuara kriteret e produkteve që janë të prodhuara përmes OMGJ.

- **Rregulloret për prodhimin e produkteve të ndryshme nga farërat dhe materiali riprodhues vegjetative.**

Prodhueset e sektorit të Bujqësisë Organike të cilët produktet e tyre i përfitojnë nga farërat dhe materiali riprodhues vegjetative, ndryshimi dhe fuqizimi i rregulloreve adekuate të Bujqësisë Organike ju siguron se materiali riprodhues bimore posedon diversitetin e lartë gjenetik dhe fenotipik dhe duhet të jetë i disponueshëm për përdorim në prodhimin organik. Përdorimi i farave me një shkallë të lartë diversitetin gjenetik, rezistencë ndaj sëmundjeve dhe jetëgjatësisë siguron certifikim më të lehtë.

- **Kriteret lidhur me përbërjen e ushqimit organik të përpunuar.**

Në mungesë të kriterëve lidhur me ushqimin organik të përpunuar, operatorët që prodhojnë ushqim organik ose ushqim për kafshë duhet t'i ndjekin procedurat e duhura bazuar në identifikimin sistematik të hapave kritikë të përpunimit, në mënyrë që të sigurohet që produktet e përpunuara të jenë në përputhje me rregullat e prodhimit organik. Produktet organike të përpunuara duhet të prodhohen duke përdorur metoda të përpunimit të cilat garantojnë ruajtjen e karakteristikave dhe cilësive organike të produkteve në të gjitha fazat e prodhimit organik.

- **Rregullat shtesë për delegimin e detyrave të kontrollit zyrtar dhe detyrave që lidhen me veprimtari të tjera zyrtare, dhe kontrollit zyrtar në lidhje me përdorimin e Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve Organike.**

Autoritetet kompetente kanë procedura dhe marrëveshje për të siguruar mbikëqyrjen e organeve të kontrollit, duke përfshirë verifikimin që detyrat e deleguara janë kryer në mënyrë efektive, të pavarur dhe objektive, veçanërisht për sa i përket intensitetit dhe shpeshtësisë së verifikimit të përputhshmërisë. Procedura e vlerësimit të rrezikut, e cila do të përcaktojë, në veçanti, bazën për intensitetin dhe shpeshtësinë e verifikimit të përputhshmërisë së operatorëve dhe grupeve të operatorëve.

- **Përfaqësimin efikas të interesave të fermerëve dhe shoqatave të fermerëve të biznesit për regjistrimin e ri dhe zhvillimin e bujqësisë organike.**

Zhvillimi i bujqësisë organike, mund të nxitë interesimin e fermerëve, dhe shoqatave të fermerëve për biznese të reja për të prodhuar produkte cilësore, të cilët mund të regjistrohen si operatorë (kompani prodhues, eksportuese dhe tregtuese) për produktet organike, andaj në bazë të kërkesave të tregut për produkte organike duhet të rritet numri i bizneseve në këtë sektor.

- **Rregullat për importin dhe eksportin e produkteve organike dhe atyre ne konvertim.**

Është shumë e nevojshme për t'ju përgjigjur pritshmërisë së konsumatorëve që produktet organike të importuara plotësojnë standarde të larta dhe për të siguruar më mirë aksesin e produkteve organike të vendit në tregun ndërkombëtar. Përveç kësaj, është e nevojshme të sigurohet qartësi në lidhje me rregullat e zbatueshme për eksportin e produkteve organike, veçanërisht duke vendosur certifikata të eksportit organik. Kjo vlen edhe për Importin dhe eksportin e prodhimeve organike ne konvertim.

Mungesa e disa specifikave gjatë procesit të konvertimit e vështirëson sigurinë e vlerësimit të tokave ku kultivohen produktet organike të cilat nuk duhet të ketë mbetje kimike nëse eventualisht janë përdorur në të kaluarën. Prandaj, pas një periudhe të përshtatshme konvertimi, njësitë bujqësore në vend që synojnë të bëhen organike duhet të menaxhohen tërësisht në përputhje me kërkesat e zbatueshme për prodhimin organik.

- **Rregullat dhe qartësinë e certifikimit grupor për standardin organik.**

Certifikimi i grupit të operatorëve është një dispozitë e re edhe për BE-në e cila është përafruar në këtë ligj, që i jep mundësi fermerëve të vegjël të certifikohen si grup, duke ulur kostot e certifikimit individual. Rregullat lidhur me përbërjen dhe funksionimin e grupit të operatorëve parashikohen të miratohen me udhëzim të ministrit. Certifikimi i grupit të operatorëve është një dispozitë e re edhe për BE-në e cila është përafruar në këtë ligj, që i jep mundësi fermerëve të vegjël të certifikohen si grup, duke ulur kostot e certifikimit individual. Rregullat lidhur me përbërjen dhe funksionimin e grupit të operatorëve parashikohen të miratohen me akt nënligjor nga Ministria.

- **Kriteret për certifikimin e verërave organike.**

Megjithatë, duke qenë se vera është një kategori specifike dhe e rëndësishme e produkteve organike, rregullat shtesë të detajuara të prodhimit duhet të përcaktohen posaçërisht për “verën organike”. Vera organike duhet të prodhohet tërësisht nga lënda e parë organike dhe duhet të lejohen të shtohen vetëm disa produkte dhe substanca të autorizuar në përputhje me këtë rregullore. Përdorimi i disa praktikave, proceseve dhe trajtimeve enologjike në prodhimin e verës organike duhet të ndalohet. Praktikrat, proceset dhe trajtimet e tjera duhet të lejohen në kushte të përcaktuara mirë sipas Rregullores (BE) 2018/848, e cila në të ardhmen do të jetë e zbatueshme edhe në vendin tonë.

- **Transpozimi i rregullave dhe direktivave të Acquis të BE-së për produktet për bujqësi organike.**

Synimi i përgjithshëm i këtij koncept dokumenti është që të krijohet korniza ligjore e cila mundëson: (i) Importin e inputeve cilësore, të cilat janë të domosdoshme për mbrojtjen e fermerëve prodhues; (ii); Ndikim në zhvillimin e sektorit të prodhimtarisë bimore cilësore; (iii) Rritjen e rendimenteve mesatare organike në nivel vendi; (iv) Përfitimi i produkteve kualitative të cilat do të kenë ndikim në shëndetin publik. Objektivat specifike të përcaktuara me këtë koncept dokument janë: (i) Transpozimi i legjislacionit të BE-së (‘Acquis’) nga sektori i Bujqësisë Organike në legjislacionin vendor; (ii) Përmirësimi i kontrollit sipas standardeve ndërkombëtare (Rregullores së re të BE-së 2018/848); (iii) Përcaktimi i institucionit përgjegjës për certifikim të produkteve organike, realizimin e testimeve duke zbatuar standardet

ndërkombëtare; (iv) Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e Ligjit dhe inspektimin e inputeve pas regjistrimit të tyre në Listën Nacionale të Inputeve Organike, dhe Listën FIBL (Lista e Inputeve Organike/Instituti Zviceran i Hulumtimeve për Kontroll Biologjike); (v) mbrojtja e fermerëve vendor nga importimi dhe tregtimi i produkteve jo cilësore dhe ngritja e vetëdijes për rolin dhe rëndësinë e Bujqësisë Organike.

- **Rregullimin e kriterëve lidhur me masat ndaj personave fizik apo juridik të cilët veprojnë në kundërshtim me Ligjin për bujqësi organike sipas Rregullores së BE-së 2016/429.**

Regjistrimi i personave fizikë dhe juridikë që angazhohen zyrtarisht në tregtinë e produkteve organike dhe vënia para drejtësisë e atyre që merren me aktivitete të paligjshme, do të ulë sasinë e produkteve organike jo cilësore dhe të dyshimta në treg. Për këtë arsye, kontrolle më të rrepta mbi tregun e produkteve organike duhet të zbatohen nga Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinës në bashkëpunim me Institutin Bujqësor të Kosovës të cilat funksionojnë në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

- **Harmonizohet me kërkesat e LPPA, sidomos sa i përket parimeve si ai vetëm një herë, parimi i mos-pagesës, apo ofrimi i shërbimeve me kohë.**

Në kuadër të këtij opsioni, do të ndërmerreshin edhe masa për ngritjen e kapaciteteve vendore për të ulur kostot për operatorët. Për më tepër, me qëllim të lehtësimit të kërkesave për ofrim të informacionit, do të ndërmerren masa për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e zgjidhjeve të teknologjisë informative. Për më tepër do të ndërmerren hapa për zhvillimin e treguesve kyç të suksesit për të matur rezultatet në zvogëlim të barrës administrative, përmes përdorimit të Modelit të Kostos Standarde.

Përveç masave si më lartë, do të vazhdohet me programet mbështetëse për fermerët, në procesin e certifikimit dhe konvertimit në mënyrën organike të prodhimit.

Në anën tjetër, si rezultat i përafrimit me legjislacionin e përmendur të BE, Ministria do të zhvillojë Listën Kombëtare të Inputeve Organike, gjë që do të mund të shtojë barrën administrative për fermerët. Megjithatë, Ministria do të ketë parasysh masat e përmendura, për zvogëlim të barrës administrative, gjatë zhvillimit të kësaj liste.

Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me tri opsionet

[Jepni një paraqitje të shkurtër narrative të tri opsioneve. Gjithashtu, paraqitni opsionin e zgjedhur dhe arsyet kryesore përse është zgjedhur.]

Krahasimi i opsioneve:

Metoda e krahasimit:			
Ndikimet relevante pozitive	Opsioni 1 Nuk ka ndryshime	Opsioni 2 Përmirësimet e kornizës aktuale ligjore	Opsioni 3 Korniza e re ligjore për PMB-të
		• Ligji për bujqësi organike i plotësuar dhe ndryshuar; • Rregullimin e data-bazës për të dhënat e shëndetit të kafshëve; • Shërbimet e ofruara të cilat do të kenë ndikim në parandalimin dhe trajtimin e kafshëve; • Përcaktimin e kriterëve lidhur me numrin e inspektimeve që do të rekrutohen; • Planifikimin e numrit të trajnimeve për inspektorë të cilat duhet të jenë së paku tri (3) trajnime; • Planifikimin e numrit të trajnimeve të stafit në nivelin lokal dhe qendror, të cilat do të jenë së	• Harmonizimin e Kornizës ligjore aktuale me atë BE-së Nr. 2018/848, e cila trajton disa çështje siç janë: ➤ Udhëzimet do të jenë më të qarta lidhur me kriteret për mbetjet e paqëllimshme të pesticideve; ➤ Siguron një kornizë më të qartë për përfshirjen e produkteve shtesë në të ardhmen; ➤ Përfshinë Marrëveshjen e Gjelbër të BE-së dhe Strategjitë Farm to Fork për Biodiversitetin; ➤ Përmirëson transparencën dhe gjurmshmërinë e produkteve organike në të gjithë zinxhirin e furnizimit, si dhe thjeshton sistemin e importit duke u kërkuar vendeve jo anëtare të BE-së që të pajtohen me standardet organike të BE-së.

		paku pesë (5) trajnime.	• Harmonizimin me standardet e BE-së dhe ato të Federatës Ndërkombëtare për Zhvillim të Bujqësisë Organike (IFOAM). • Rregullimin e çështjen e emërtimeve që përdoren në etiketimin, materialin reklamues ose dokumentet tregtare për produktet organike. • Qartësinë në lidhje me trajtimin e produkteve organike të kontaminuara me pesticide që nuk lejohen në bujqësinë organike. • Përfshirjen e produkteve dhe substancave organike që lejohen të përdoren në prodhimtarinë organike. • Rregullimin e disa specifikave gjatë procesit të konvertimit nga bujqësia konvencionale në bujqësi organike të qëndrueshme me efekte mjedisore dhe luftimin e ndryshimeve klimatike. • Rregullimin e kriterëve të produkteve që janë të prodhuara përmes Organizmave të Modifikuar Gjenetikisht (OMGJ). • Rregulloret për prodhimin e produkteve
--	--	--------------------------------	--

			të ndryshme nga farërat dhe materiali riprodhuese vegjetative. • Kriteret lidhur me përbërjen e ushqimit organik të përpunuar. • Rregulloret shtesë për delegimin e detyrave të kontrollit zyrtar dhe detyrave që lidhen me veprimtari të tjera zyrtare, dhe kontrollit zyrtar në lidhje me përdorimin e Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve Organike. • Përfaqësimin efikas të interesave të fermerëve dhe shoqatave të fermerëve të biznesit për regjistrimin e ri dhe zhvillimin e bujqësisë organike. • Rregullat për importin dhe eksportin e produkteve organike dhe atyre në konvertim. • Rregullat dhe qartësinë e certifikimit grupor për standardin organik. • Kriteret për certifikimin e verërave organike. • Transpozimi i rregullave dhe direktivave të Acquis të BE-së për produktet për bujqësi organike. • Rregullimin e kriterëve lidhur me masat ndaj personave fizik apo
--	--	--	--

							juridik të cilët veprojnë në kundërshtim me Ligjin për bujqësi organike sipas Rregullores së BE-së 2016/429.			
Ndikimet relevante negative										
Përfitimet							Kontrolli i fermerëve gjatë procesit të konvertimit dhe certifikimit. Ndikimi i bujqësisë organike në shëndetin publik, ekonominë dhe shoqërinë. Shfrytëzimi më i mirë i burimeve, sipas rrezikut, duke kursyer kohë dhe para për regjistrimin, tregtimin dhe përdorimin e PMB-ve organike. Produkte të shëndetshme për konsumatorët dhe ndihma e zhvillimit të sektorit të bujqësisë organike, duke përmirësuar kështu rritjen ekonomike dhe duke çuar në rritje dhe vende pune dhe arritjen e zbutjes së varfërisë. Rritja e konkurrencës së prodhimit kombëtar Lehtësimi i tregtisë me produkte organike të sigurta. Kursime optimale në kosto dhe kohë për palët			
Vlerësimi i ndikimit të	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 1	Viti 2	Viti 3	

prishëm buxhetor									
Përfundimi	Zbatimi i Ligjit të ri për bujqësi organike kërkon kosto për administrimin, ngritjen e kapaciteteve, kontrollet zyrtare si dhe buxhetin për zbatimin e Ligjit.			Kostot e ngjashme me Opsionin 1			Zbatimi i Ligjit të ri për bujqësi organike kërkon kosto për administrimin, ngritjen e kapaciteteve, kontrollet zyrtare, buxhetin për zbatimin e Ligjit dhe monitorimin e prodhuesve organik. Do të kërkojë gjithashtu disa burime financiare të rëndësishme për njohjen me dispozitat e reja, por kjo do të jetë e kufizuar pasi do të kërkohej vetëm në fillim, pasi të miratohet Ligji. Ky opsion do të kërkojë edhe kosto substanciale sa i takon zhvillimit të zgjidhjeve TIK.		

Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm

Opsioni 3 parasheh hartimin e Projekt Ligjit për Bujqësi Organike, i cili do të eliminoj shkaqet dhe efektet e cekura të definimi i problemit.

Me hartimin e Ligjit të ri për Bujqësi Organike pritet të ketë një funksionim më efikas të sistemit të kontrollit dhe tregut të produkteve organike, rritje të numrit të operatorëve të prodhimit dhe përpunimit organik, komunikim dhe shkëmbim të informacionit midis autoriteteve kompetente të kontrollit zyrtar dhe trupave të kontrollit, duke siguruar besimin te konsumatori për produktet e etiketuara ose reklamuar si organike.

Baza për hartimin e Legjislacionit

Duke marrë parasysh shëndetin e konsumatorit, zhvillimin ekonomik të vendit dhe mbrojtjen e mjedisit Parlamenti Evropian dhe Këshilli Evropian në tetor të vitit 2018 miratuan Rregulloren (BE) 2018/848 për bujqësi organike. Ligji për bujqësi organike është produkt i kësaj rregullore të BE-së. Qëllimi i kësaj rregullore është menaxhimi i fermës dhe prodhimi i ushqimit që kombinon praktikat më të mira të veprimit mjedisor dhe klimatik, një nivel të lartë të biodiversitetit, ruajtjen e burimeve natyrore dhe zbatimin e standardeve të larta të mirëqenies së kafshëve dhe standardeve

të larta të prodhimit në përputhje me kërkesat e konsumatorëve për produktet e prodhuara duke përdorur substanca dhe procese natyrore. Prandaj, prodhimi organik luan një rol të dyfishtë shoqëror, ku, nga njëra anë, siguron një treg specifik që i përgjigjet kërkesës së konsumatorit për produkte organike dhe, nga ana tjetër, ofron mallra të disponueshme që kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit dhe mirëqenien e kafshëve, si dhe zhvillimin rural.

Prandaj është shumë e nevojshme që edhe Ligji i vjetër për Bujqësi Organike në Kosovë harmonizohet me Rregulloren (BE) 2018/848.

Opsioni 3 mund të trajton te gjitha problemet e lartpërmendura në mënyrën e duhur dhe duhet të arrijë objektivat kryesore të dhënies së qartësisë dhe koherencës së një strategjie dhe kornize të përgjithshme. Pritet të ketë ndikime më të qarta dhe më të thella pasi do të mundësojë ndryshime legislative në politikat për bujqësi organike. Mundësisë është që të jetë më efikase në afat më të gjatë për palët e interesuara të sektorit të bujqësisë organike.

Opsionet 1 dhe 2 nuk konsiderohen relevante dhe të krahasueshme me opsionin e 3 pasi ato nuk do të sjellin ndryshime në opsionet e politikave, qasjen dhe zhvillimet, as në grupin e parimeve të koherencës ose qasjes gjithëpërfshirëse, dhe kështu nuk do të kishte ndryshime thelbësore në politikat për bujqësi organike.

Vlerësimi i ardhshëm

Monitorimi do të bëhet përmes strukturave ekzistuese dhe Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve në bashkëpunim me palët e interesuara. Gjithashtu, Udhëzuesi për vlerësimin legjislativ i cili u miratua në vitin 2015 dhe çdo vit kryen disa vlerësime nën ombrellën e Strategjisë për rregullim më të mirë.

Shtojca 1: Formulari i vlerësimit të ndikimit ekonomik

Kategoria e ndikimeve ekonomike	Ndikimet kyçe	A pritët të ndodh ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe / ose individëve të prekur	Përfitimet ose kostot e pritshme të ndikimit	Nivelet e preferuara të analizave
		Po	Jo			
Vende pune ²	A do të rritet numri i vendeve të punës që është në dispozicion?	X				
	A do të ulët numri i vendeve të punës në dispozicion?		X			
	A do të ketë efekt në nivelin e pagesës?	X				
	A do të ketë efekt në lehtësinë e gjetjes së një pune?	X		I ulët		
Bërja e biznesit	A do të ketë efekt në qasjen në financa për biznesin?	X				
	A do të hiqen disa produkte nga tregu?	X				
	A do të lejohen produkte të caktuara në treg?	X				
	A do të duhet të mbyllen bizneset?		X			
	A do të krijohen biznese të reja?	X				
Përgjegjësitë Administrative	A do të duhet të përmbushin bizneset detyrimet e reja të informacionit?	X				
	A janë thjeshtuar detyrimet e informacionit për bizneset?	X				
Tregtia	A pritët të ndryshojnë flukset aktuale të importeve?	X				

² Kur ka ndikim në punë, do të ketë edhe ndikime sociale.

Kategoria e ndikimeve ekonomike	Ndikimet kyçe	A pritet të ndodh ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe / ose individëve të prekur	Përfitimet ose kostot e pritshme të ndikimit	Nivelet e preferuara të analizave
		Po	Jo			
	A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të eksporteve?	X				
Transporti	A do të ketë ndikim në mënyrën se si do të transportohen pasagjerët dhe/ose mallrat?		X			
	A do të ketë një ndryshim në kohë që është për transportin e pasagjerëve dhe/ose mallrave?		X			
Investimet	A pritet që kompanitë të investojnë në aktivitete të reja?	X				
	A pritet që kompanitë të anulojnë apo shtyjnë investimet?		X			
	A do të rriten investimet nga diaspora?	X				
	A do të ulen investimet nga diaspora?		X			
	A do të rriten investimet e huaja direkte?	X				
	A do të ulen investimet e huaja direkte?		X			
Konkurrenca	A do të rritet çmimi i inputeve të biznesit, si energjia elektrike?		X			
	A do të ulët çmimi i inputeve të biznesit, si energjia elektrike?		X			
	A ka gjasa të promovohet inovacioni apo kërkimi?	X				
	A ka gjasa të pengohen inovacioni dhe kërkimi?		X			
Ndikimi në NVM	A janë kompanitë që prekin kryesisht NVM-të?	X				
	A do të rritet numri i mallrave dhe shërbimeve të disponueshme për biznesin apo konsumatorët?	X		I ulët		

Kategoria e ndikimeve ekonomike	Ndikimet kyçe	A pritet të ndodh ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe / ose individëve të prekur	Përfitimet ose kostot e pritshme të ndikimit	Nivelet e preferuara të analizave
		Po	Jo			
Çmimet dhe konkurrenca	A do të ulët numri i mallrave dhe shërbimeve të disponueshme për biznesin apo konsumatorët?		X			
	A do të rriten çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?	X		I ulët		
	A do të ulen çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?		X			
Ndikimi ekonomik rajonal	A do të preket një sektor specifik i biznesit?	X				
	A është ky sektor i përqendruar në një rajon të caktuar?		X			
Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik	A do të ndikohet rritja ekonomike në të ardhmen?	X				
	A mund të ketë efekt në normën e inflacionit?		X			

Shtojca 2: Formulari i vlerësimit të ndikimit social

Përfshirja sociale	Ndikimet kyçe	A pritët të ndodh ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe / ose individëve të prekur	Përfitimet ose kostot e pritshme të ndikimit	Nivelet e preferuara të analizave
		Po	Jo			
Vende pune ³	A do të rritet numri i vendeve të punës në dispozicion?	X				
	A do të ulët numri i vendeve të punës në dispozicion?		X			
	A preken vendet e punës në një sektor specifik biznesi?		X			
	A do të ketë efekt në nivelin e pagesës?	X				
Ndikimet sociale rajonale	A janë të përqendruara ndikimet sociale në një rajon të caktuar apo në qytete të veçanta?		X			
Kushtet e punës	A preken të drejtat e punëtorëve?		X			
	A janë futur apo hequr standardet për të punuar në kushte të rrezikshme?		X			
	A do të ketë efekt në mënyrën se si zhvillohet dialogu social ndërmjet punonjësve dhe punëdhënësve?		X			
Përfshirja sociale	A do të ketë ndikim në varfëri?	X				
	A ndikohet qasja në skemat e mbrojtjes sociale?		X			
	A do të ndryshojë çmimi i mallrave dhe shërbimeve bazë?		X			
	A do të ketë ndikim në financimin apo organizimin e skemave të mbrojtjes sociale?		X			
Arsimimi	A do të ketë efekt në arsimin fillor?		X			

Përfshirja sociale	Ndikimet kyçe	A pritët të ndodh ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe / ose individëve të prekur	Përfitimet ose kostot e pritshme të ndikimit	Nivelet e preferuara të analizave
		Po	Jo			
	A do të ketë efekt në arsimin e mesëm?	X		I ulët		
	A do të ketë efekt në arsimin terciar?	X		I ulët		
	A do të ketë efekt në trajnime profesionale?	X		I ulët		
	A do të ketë efekt në arsimimin e punëtorëve dhe mësimin e përjetshëm?	X				
	A do të ketë efekt në organizimin apo strukturën e sistemit arsimor?		X			
	A do të ketë ndikim në lirinë akademike dhe vetëqeverisjen?		X			
Kultura	A ndikon opsioni në diversitetin kulturor?		X			
	A ndikon opsioni në financimin e organizatave kulturore?		X			
	A ndikon opsioni në mundësitë që njerëzit të shijojnë aktivitetet kulturore ose të marrin pjesë në to?		X			
	A ndikon opsioni në ruajtjen e trashëgimisë kulturore?		X			
Qeverisja	A ndikon opsioni në aftësinë e qytetarëve për të marrë pjesë në procesin demokratik?		X			
	A trajtohet çdo person në mënyrë të barabartë?	X				
	A do të informohet më mirë publiku për disa çështje?	X				
	A ndikon opsioni në mënyrën se si funksionojnë partitë politike?		X			
	A do të ketë ndikim në shoqërinë civile?		X			.

Përfshirja sociale	Ndikimet kyçe	A pritët të ndodh ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe / ose individëve të prekur	Përfitimet ose kostot e pritshme të ndikimit	Nivelet e preferuara të analizave
		Po	Jo			
Shëndeti dhe siguria publike ⁴	A do të ketë një efekt në jetën e njerëzve, si jetëgjatësia apo shkalla e vdekshmërisë?	X				
	A do të ketë ndikim në cilësinë e ushqimit?	X				
	A do të rritet apo ulet rreziku për shëndetin për shkak të substancave të dëmshme?	X				
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në nivelet e zhurmës apo cilësisë së ajrit, ujit dhe/ose tokës?		X			
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në përdorimin e energjisë?		X			
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në depozitimin e mbetjeve?		X			
	A do të ketë një efekt në stilin e jetës së njerëzve, të tilla si nivelet e marrjes së sporteve, ndryshimet në dietë ose ndryshimet në përdorimin e duhanit ose alkoolit?		X			
	A ka grupe specifike që përballen me rreziqe shumë më të larta se të tjerët (të përcaktuara nga faktorë të tillë si mosha, gjinia, paaftësia, grupi social ose rajoni)?		X			
Krimi dhe siguria	A preken shanset që kriminelët të kapen?		X			
	A ndikohet përfitimi i mundshëm nga krimi?		X			
	A ka ndonjë efekt në nivelet e korrupsionit?		X			
	A preket kapaciteti i zbatimit të ligjit?		X			
	A ka ndikim në të drejtat dhe sigurinë e viktimave të krimit?		X			

⁴ Kur ka ndikime në shëndetin dhe sigurinë publike, ka rregullisht edhe ndikime mjedisore.

Shtojca 3: Formulari i vlerësimit të ndikimit në mjedis

Kategoria e ndikimit mjedisor	Ndikimet kyçe	A pritët të ndodh ky ndikim?		Numri i organizatorëve, kompanive dhe/apo individëve të prekur	Përfitimet ose kostot e pritshme të ndikimit	Nivelet e preferuara të analizave
		Po	Jo			
Klima dhe mjedisi i qëndrueshëm	A do të ketë efekt në emetimin e gazeve serrë (dyoksid karboni, metan etj.)?		X			
	A do të ndikohet konsumi i karburantit?		X			
	A do të ndryshojë përzierja e burimeve që përdoren për prodhimin e energjisë?		X			
	A do të ketë ndryshim në çmim për produktet miqësore me mjedisin?		X			
Cilësia e ajrit	A do të ketë efekt në emetimin e ndotësve të ajrit?		X			
Cilësia e ujit	A ndikon opsioni në cilësinë e ujit të freskët?		X			
	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave nëntokësore?		X			
	A ndikon opsioni në burimet e ujit të pijshëm?		X			
Cilësia e tokës dhe shfrytëzimi i tokës	A do të ketë ndikim në cilësinë e tokës (në lidhje me acidifikimin, kontaminimin, përdorimin e pesticideve ose herbicideve)?		X			
	A do të ketë ndikim në erozionin e tokës?		X			
	A do të humbasë toka (përmes ndërtimit etj.)?		X			
	A do të fitohet dheu (përmes dekontaminimit etj.)?		X			

Kategoria e ndikimit mjedisor	Ndikimet kyçe	A pritet të ndodh ky ndikim?		Numri i organizatorëve, kompanive dhe/apo individëve të prekur	Përfitimet ose kostot e pritshme të ndikimit	Nivelet e preferuara të analizave
		Po	Jo			
	A do të ketë një ndryshim në përdorimin e tokës (p.sh. nga përdorimi pyjor në përdorim bujqësor ose urban)?		X	I ulët		
Mbetjet dhe riciklimi	A do të ndryshojë sasia e mbeturinave që krijohen?		X			
	A do të ndryshojnë mënyrat se si trajtohen mbetjet?		X			
	A do të ketë efekt në mundësitë e riciklimit të mbetjeve?	X		I ulët		
Shfrytëzimi i resurseve	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve të rinovueshme (stoqet e peshkut, hidrocentralet, energjia diellore etj.)?		X			
	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve që nuk janë të rinovueshme (ujëra nëntokësore, minerale, qymyr etj.)?		X			
Shkalla e rreziqeve mjedisore	A do të ketë një efekt në mundësitë e rreziqeve të tilla si zjarre, përhapje apo aksidente?		X			
	A do të ketë efekt në gatishmërinë kur ndodhin fatkeqësi natyrore?		X			
	A ndikohet mbrojtja e shoqërisë nga fatkeqësitë natyrore?		X			
Biodiversiteti, flora dhe fauna	A do të ketë efekt mbi speciet e mbrojtura apo të rrezikuara apo zonat ku ato jetojnë?	X				

Kategoria e ndikimit mjedisor	Ndikimet kyçe	A pritet të ndodh ky ndikim?		Numri i organizatorëve, kompanive dhe/apo individëve të prekur	Përfitimet ose kostot e pritshme të ndikimit	Nivelet e preferuara të analizave
		Po	Jo			
	A do të ndikohet madhësia ose lidhjet ndërmjet zonave natyrore?		X			
	A do të ketë një efekt në numrin e specieve në një zonë të caktuar?	X		I ulët		
	A do të ketë efekt në trajtimin e kafshëve?	X		I ulët		
Mirëqenia e kafshëve	A do të ketë ndikim në shëndetin e kafshëve?	X				
	A do të ketë efekt në cilësinë dhe sigurinë e ushqimit të kafshëve?	X				

Shtojca 4: Formulari i vlerësimit të ndikimit për të drejtat themelore

Kategoria e ndikimit të drejtave themelore	Ndikimet kyçe	A pritët të ndodh ky ndikim?		Numri i organizatorëve, kompanive dhe/apo individëve të prekur	Përfitimet ose kostot e pritshme të ndikimit	Nivelet e preferuara të analizave
		Po	Jo	E lartë / e ulët	E lartë /e ulët	
Dinjiteti	A ndikon opsioni në dinjitetin e njerëzve, të drejtën e tyre për jetë apo integritetin e një personi?		X			
Liria	A ndikon opsioni në të drejtën e lirisë së individëve?		X			
	A ndikon opsioni në të drejtën e një personi për privatësi?		X			
	A ndikon opsioni në të drejtën për t'u martuar ose për të krijuar familje?		X			
	A ndikon opsioni në mbrojtjen ligjore, ekonomike apo sociale të individëve apo familjes?		X			
	A ndikon opsioni në lirinë e mendimit, ndërgjegjes apo fesë?		X			
	A ndikon opsioni në lirinë e shprehjes?		X			
	A ndikon opsioni në lirinë e tubimit apo shoqërimit?		X			
Të dhënat personale	A përfshin opsioni përpunimin e të dhënave personale?	X				
	A garantohej e drejta e individit për qasje, korrigjim dhe kundërshtim?		X			
	A është mënyra e qartë se si përpunohen të dhënat personale dhe mbrohen mirë?		X			
Azili	A ndikon opsioni në të drejtën e azilit?		X			

Të drejtat e pronës	A do të preken të drejtat pronësore?		X			
	A ndikon opsioni në lirinë për të kryer biznes?		X			
Trajtimi i barabartë gjinor	A e ruan opsioni parimin e barazisë përpara ligjit?	X				
	A ka shanse që grupe të caktuara të vuajnë drejtpërdrejt ose tërthorazi nga diskriminimi (p.sh. ndonjë diskriminim i bazuar në çfarëdo baze si gjinia, raca, ngjyra, përkatësia etnike, pakica kombëtare, politike ose ndonjë opinion tjetër, mosha ose orientimi seksual)?		X			
	A ndikon opsioni në të drejtat e personave me aftësi të kufizuara?		X			
Të drejtat e fëmijëve	A ndikon opsioni në të drejtat e fëmijëve?		X			
Administrimi i mirë	A do të bëhen më të rënduara procedurat administrative?		X			
	A ndikohet mënyra në të cilën administrata merr vendime (transparenca, koha procedurale, e drejta për qasje në një dosje etj.)?	X				
	Për ligjin penal dhe sanksionet e parashikuara: a preken të drejtat e të akuzuarit?		X			
	A ndikohet qasja në drejtësi?		X			